



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 31 Akti

Nr. 84 Vendimi
Tiranë, më 27.11.2018

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Olsi Komici	Kryesues
Lulzim Hamitaj	Relator
Brunilda Bekteshi	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Denisa Kosta, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Mia Roessingh, në Tiranë, më datë 23 nëntor 2018, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:

Z. Besnik Cani, me detyrë prokuror pranë Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan - pa përfaqësues.

OBJEKTI:

Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE:

Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, si dhe pasi shqyrtoi dhe diskutoi mbi tërësinë e çështjes që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, z. Besnik Cani, i cili në seancën dëgjimore publike të datës 23.11.2018 kërkoi konfirmimin e tij në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

- i. Z. Besnik Cani, për shkak të funksionit të tij si prokuror pranë Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr. 84/2016¹;
- ii. Subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e kandidatit në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, në bazë të nenit 279 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit me përparësi, duke u shortuar si subjekt rivlerësimi, më datë 30.11.2017, në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit”, nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si “Komisioni”);
- iii. Pas hedhjes së shortit, trupi gjykues nr. 3, pasi administroi dhe studioi tre raportet e institucioneve të parashikuara nga nenet 31 - 44 të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 1, datë 14.12.2017, vendosi: (i) të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të po këtij ligji; (ii) me mirëkuptim, të caktohet kryesuesi i trupit gjykues, komisionere Brunilda Bektoshi. Gjithashtu, në këtë mbledhje, anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit;
- iv. Në lidhje me ecurinë e fazës hetimore mbi rivlerësimin e z. Besnik Cani, specifikoheq që, pasi Komisioni kishte zhvilluar një fazë hetimore, në vijim të së cilës, trupi gjykues, më datë 20.07.2018, me vendimin nr. 2, kishte vendosur mbylljen e hetimeve, vetëm për kriterin e pasurisë dhe, më datë 21 korrik 2018, i kishte njoftuar subjektit të rivlerësimit rezultatet respektive;
- v. Por, pasi shqyrtoi shpjegimet, dokumentacionin e depozituar dhe kërkesat e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues me vendimin nr. 3, më datë 07.08.2018, vendosi rihapjen e hetimit mbi të tri kriteret e rivlerësimit, i cili i është njoftuar subjektit të rivlerësimit në të njëjtën datë;
- vi. Në vijim të hapave të mëtejshëm hetimorë, më datë 15 nëntor 2018, me vendimin nr. 4, trupi gjykues vendosi të rimbyllë fazën hetimore, dhe në bazë të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016,

¹ Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i ligjit nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar” dhe ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim referuar si “Ligji nr. 84/2016”), parashikojnë se: “Të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohen rivlerësimit *ex officio*”.

- vlerësoi që procesi i rivlerësimit për z. Besnik Cani, të bazohej në të tri kriteret e rivlerësimit të parashikuar nga ligji nr. 84/2016;
- vii. Më datë 15.11.2018, Komisioni, njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht dhe anekset relative; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të sjellë shpjegime dhe prova të mundshme për të provuar të kundërtën, brenda datës 20 nëntor 2018; (iii) për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative;
- viii. Më datë 20.11.2018, subjekti i rivlerësimit paraqiti shpjegimet e tij, të shoqëruara me dokumentacion mbështetës, mbi rezultatet e hetimit kryesisht;
- ix. Më datë 21.11.2018, trupi gjykues, me anë të vendimit nr. 5 vendosi të ftoj, – përmes postës elektronike, – subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit, u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej më datë 23 nëntor 2018. Datë në të cilën u zhvillua rregullisht seanca dëgjimore, ku subjekti i rivlerësimit ishte prezent.

II. SEANCA DËGJIMORE

- i. Seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit, z. Besnik Cani, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/201, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Mia Roessingh. Në fillim të seancës dëgjimore, të datës 23 nëntor 2018, pasi u verifikua prezenca e subjektit të rivlerësimit, dhe e vëzhguesit ndërkombëtar, përpara sesa të merrte fjalën relatori, nga ana e kryesuesit të seancës u kryen njoftimet e nevojshme për publikun dhe mediat prezent/e;
- ii. Më pas, e mori fjalën relatori i çështjes, i cili paraqiti rezultatet e arritura nga Komisioni përgjatë hetimeve të kryera si në fazën e parë - ku rezultatet ishin kristalizuar vetëm mbi kriterin e pasurisë, - dhe në fazën e dytë (pas rihapjes së hetimeve, mbi të tri kriteret e rivlerësimit), ku nëpërmjet shqyrtimit, edhe vlerësimit të dokumentacionit të administruar, ishte konkluduar në rezultate mbi të tri kriteret;
- iii. Në vijim, pasi dëgjoji relacionin, z. Besnik Cani, shprehu qëndrimin e tij, duke parashtruar shpjegimet përkatëse të detajuara lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij;
- iv. Gjithashtu, në fund të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit shprehu qëndrimin e tij përfundimtar të argumentuar dhe në konkluzion, ai kërkoi konfirmimin e tij në detyrë.
- v. Seanca dëgjimore e datës 23.11.2018 u ndërpre, për të rifilluar më datë 27.11.2018, për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

- i. Subjekti i rivlerësimit, ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur në kohë, kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, përgjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar ndaj tij;

- ii. Gjithashtu, duhet theksuar fakti që, z. Besnik Cani, për dy herë radhazi, më datë 23.04.2018 dhe 31.07.2018, në të njëjtën çështje, ka kërkuar përjashtimin e relatorit² të çështjes, komisioner Lulzim Hamitaj, me pretendimet se: “... ky komisioner po zhvillon hetime të thelluara dhe tendencioze, me qëllim shkarkimin tim nga detyra. Po ashtu, veç të tjerash, ai pohonte që, edhe pse nuk e njoh dhe nuk kam pasur asnjë takim apo problem me z. Hamitaj, ai ndoshta është i influencuar nga njerëz që më duan të keqen³, dhe për rrjedhojë nuk mund të jetë objektiv dhe i paanshëm në rivlerësimin tim ...”, si dhe për faktin që “... ky komisioner nuk është i besueshëm ... etj.”;
- iii. Pasi janë shortuar sipas rregullores, trupat gjykuese respektivë, për të vlerësuar kërkesat për përjashtim, dhe pas shqyrtimit të tyre, me vendimet e datës 02.05.2018 dhe 01.08.2018, në të dyja rastet është vendosur rrëzimi i kërkesave të paraqitura, pasi ato janë çmuar të pa bazuara në ligj dhe në prova.

IV. HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu një hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”; b) raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI; c) raportin mbi kontrollin e figurës, të dorëzuar pranë Komisionit nga DSIK-ja; d) provat shkresore/dokumentet të/e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; e) opinionin e paraqitur nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit pranë Komisionit, - në bazë të nenit “B” të Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016; f) deklaratimet dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit, të bëra me anë të komunikimit elektronik; g) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës, të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, pas njoftimeve të mbylljes së hetimeve administrative si dhe argumentimeve me gojë në seancë dëgjimore - për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit; h) deklaratimet e personave të tjerë të dëgjuar; i) faktet e njohura botërisht.

A - Procesi i rivlerësimit për kriterin e pasurisë

Bazuar në nenet 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ka dërguar, me shkresën nr. (***), në datën 16.11.2017, raportin lidhur me deklaratimet dhe vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Besnik Cani, ku konstatohet se:

- *Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *Ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *Nuk ka kryer deklarim të rremë;*

² Edhe pse Komisioni nuk i kishte njoftuar subjektin se kush ishte relatori në procesin e rivlerësimit të tij;

³ Duke radhitur një sërë hipotezash, pa baza konkrete, por që thjeshtë subjekti i kishte menduar si të mundshme;

➤ *Subjekti i rivlerësimit nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse mbi të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

Hetimi administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë konsistoi në: verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; në verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme, të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; në evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; në evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga neni 33, pika 5, i ligjit nr. 84/2016.

Mbi asetet e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016:

- i. Apartament banimi, me sip. 117 m², ndodhur në, “Rr. (***)” - Tiranë;
- ii. Truall me sipërfaqe 633 m² dhe ndërtesë prej 112 m², P. - Tiranë;
- iii. Truall me sipërfaqe 363 m², P. - Tiranë;
- iv. Garazh me sipërfaqe 18,7 m², ndodhur në, Rr. “(***)” - Tiranë;
- v. Autoveturë, “Mercedes-Benz”, tip B180, viti i prodhimit 2006.

A/1. Në lidhje me truallin dhe banesën e ndërtuar në P. (Tiranë)

- i. **Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar** në deklaratën “Vetting”, një truall prej 633,9 m² dhe një banesë private me sip. 100 m², - të legalizuara nga ALUIZNI në vitin 2008 - e ndërtuar, me kursime familjare të realizuara edhe nga emigracioni, në vitet 1993 - 1994;
- ii. Kostoja e ndërtimit të kësaj banese në P. është deklaruar në vlerën rreth 700.000 lekë, por pa e provuar me dokumente as shpenzimet e kryera dhe as burimin e tyre;
- iii. Janë konstatuar pasaktësi dhe mospërputhje në lidhje me deklaratimet e ndryshme të paraqitura nga subjekti në deklaratat periodike si dhe në formularët e ALUIZNI-t, për sa u përket sipërfaqeve të terrenit dhe të banesës së ndërtuar mbi të;
- iv. Gjithashtu, deklarimi i terrenit të sipërpërmendur është kryer vetëm në vitin 2008, pranë ILDKPKI-së.

1.1 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit, në lidhje me problematikat mbi këtë pasuri

Në lidhje me mospërputhjet e konstatuara mbi këtë pronësi, subjekti i rivlerësimit, si nëpërmjet përgjigjeve të pyetësorit, edhe në shpjegimet e dhëna pas njoftimit të rezultateve të hetimit dhe kalimit të barrës së provës, ka shpjeguar se:

- i. *Ndërtimi i banesës është kryer me “argatë”, pra me krahë pune falas, nga të afërmit e vetë, përpara sesa ai të emërohej në funksionin e prokurorit dhe që e ka të pamundur për të prodhuar*

dokumente provues, për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar dhe të informalitetit prezent asokohe në vend;

- ii. *Burimi i të ardhurave për ndërtimin e banesës në fjalë ka qenë nga kursime familjare të realizuara edhe nga emigracioni, në vitet 1993 - 1994, të cilat është në pamundësi për ti provuar;*
- iii. *Për sa u përket mospërputhjeve mbi sipërfaqen e deklaruar të ndërtesës, subjekti sqaron se ky ndërtim nuk është realizuar me një projekt paraprak, ku të ishte paracaktuar dhe saktësuar sipërfaqja për tu ndërtuar, si dhe nuk posedoheshin dokumente pronësie në lidhje me të, gjë që nuk mundësonte njohjen ekzakte të sipërfaqes së godinës;*
- iv. *Në lidhje me terrenin, subjekti ka pohuar se, - në mungesë udhëzimesh të qarta dhe pa eksperiencë në deklarime, duke mos e konsideruar si të duhur më parë, - ai e ka deklaruar atë me sipërfaqe prej 700 m², menjëherë në momentin e nisjes së procedurës së legalizimit, pa e konsideruar më parë si një send në posedim të plotë dhe të vazhdueshëm, për të cilin mund të kishte detyrimin e deklarimit, pasi ishte informal dhe nuk dihej se çfarë qëndrimi do të mbante edhe shteti në lidhje me këtë informalitet. Sipërfaqja e deklaruar 700 m² rezulton shumë afër asaj të konstatuar nga matjet e specialistëve të asaj fushe, prej 633,9 m² dhe ky mund të konsiderohet një gabim i kuptueshëm njerëzor, - i shkaktuar nga diferencat midis matjes vizuale dhe matjes faktike - që nuk ka pasur për qëllim fshehjen e pasurisë;*
- v. *Për sa i përket mospërputhjeve të mundshme të dokumentacionit të ALUIZNI-t apo të ZVRPP-së, subjekti shprehet se ai ka kryer një procedurë të rregullt legalizimi, siç konfirmohet edhe nga vetë dokumentacioni i lëshuar nga këto institucione dhe i paraqitur pranë Komisionit⁴;*
- vi. *Për sa i përket faktit të ndërtimit pa leje, kjo është një çështje e tejkaluar nga momenti që Komisioni, në dy raste të tjera të ngjashme, ka vlerësuar pa pasoja këtë rrethanë dhe i ka konfirmuar në detyrë subjektet në fjalë;*
- vii. *Në lidhje me mënyrën dhe kostot e ulëta të ndërtimit të banesës në P., si dhe mbi periudhën e transferimit aty, janë paraqitur katër deklarata noteriale⁵ si dhe një vërtetim i Komunës P. i datës 12.04.1996;*
- viii. *Subjekti për sa më lart, ka konkluduar se periudha në të cilën është kryer ndërtimi në fjalë është jashtë kompetencës së Komisionit, pasi organet e rivlerësimit mund të verifikojnë dhe rivlerësojnë pasuritë duke u nisur nga data që subjektet janë emëruar në detyrën e tyre.*

1.2 Arsytimi ligjor në lidhje me faktet

- i. Komisioni, mbështetur në provat e administruara dhe në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me deklaratimet dhe veprimet faktike dhe juridike të kryera mbi pasurinë objekt shqyrtimi, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të pasakta në lidhje me sipërfaqet e banesës dhe të terrenit në P., si dhe ka munguar të deklarojë posedimin e terrenit në vitet para legalizimit;
- ii. Gjithsesi shpjegimet dhe dokumentacionet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit konsiderohen deri diku bindës për sa u përket pasaktësive. Por nga këndvështrimi juridiko - ligjor, - edhe pse mund të konsiderohet si një fakt historik real informaliteti në Shqipëri asokohe – subjekti, përtej shpjegimeve, nuk ka dhënë asnjë provë konkrete lidhur me shpenzimet e kryera për ndërtimin e banesës në P. dhe të burimit të tyre;

⁴ Shih shkresën e ZVRPP-së Tiranë, datë 24.07.2018.

⁵ Deklarata të datës 28.07.2018, nga shtetasit: M.K.; B.C.; L.D.; I.N.

- iii. Për sa i përket mosdeklarimit të terrenit përpara legalizimit, mund të konkludohet që realisht kjo mangësi - përtej mungesës së udhëzimeve dhe të eksperiencës, për deklarimin e sendeve në posedim informal (të pretenduar nga subjekti), - nuk mund të konsiderohet si një fshehje pasurie. Ky konkluzion bazohet në faktin që pikërisht kjo pasuri nuk ishte e blerë ose e dhuruar, por thjeshtë në rrugë informale, ishte marrë në shfrytëzim/posedim. Kjo rrethanë mund të shpjegojë paqartësitë/pasaktësitë për sa i përket sipërfaqes së tokës së deklaruar. Në çdo rast, subjekti nuk do të kishte pasur arsye/detyrim për të deklaruar burimin e shpenzimit për këtë pasuri, thjesht për faktin që ai nuk kishte kryer asnjë shpenzim për këtë send;
- iv. Në vijim të arsyetimeve të mësipërme, Komisioni arrin në përfundimin se, nga analiza dhe vlerësimi i veprimeve juridike dhe deklarimeve që subjekti i rivlerësimit ka dhënë në lidhje me këtë pasuri, edhe pse nuk rezulton i provuar çdo pretendim i tij, në vetvete dhe të vetme këto pasaktësi apo veprime ose mosveprime, nuk mund të pasjellin aplikimin e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, pasi kjo do të binte ndesh me parimin e proporcionalitetit.

A/2. Në lidhje me apartamentin e banimit, me sip. 117 m², ndodhur në, Rr. “(*)” - Tiranë**

- i. Në deklaratën e vitit 2005 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar blerjen e kësaj pasurie - me kontratë sipërmarrje, të muajit shtator 2005, - me çmim në vlerën 69.000 euro, si dhe një pagesë paraprake, në shumën prej 21.000 eurosh, për këtë apartament në favor të shoqërisë “(***)”sh.p.k.;
- ii. Lidhur me burimin e të ardhurave të kësaj pagese, në shumën prej 21.000 eurosh, është deklaruar të jetë përdorur, veç të tjerash, edhe shuma prej 3.500 USD, të mbartura nga viti 2004, por që nuk ka qenë e deklaruar si gjendje në vitin 2004;
- iii. Gjithashtu, deklarohet të jetë përdorur për pagesën e vlerës 21.000 euro, edhe një sasi në shumën prej 6.000 eurosh, të marra hua nga z. P. T. – banues në Greqi. Pasi subjektit të rivlerësimit ju kërkuan shpjegime dhe prova mbi këtë rrethanë me pyetësor, ai paraqiti një deklaratë konfirmuese të z. P. T. si dhe dokumentacion mbi të ardhurat vjetore të këtij të fundit, që e justifikonin burimin e ligjshëm;
- iv. Për sa më lart, në justifikim të burimit financiar, për pagesën e sipërpërmendur, të shumës prej 21.000 eurosh, në vitin 2005 subjekti i rivlerësimit deklaronte: (i) - kursime të vitit 2005, në shumën prej **1.050.000 lekësh**; (ii) - marrje hua nga të afërmit në shumën **500.000 lekë**, pa afat dhe pa interes; (iii) – tërheqje shume nga një mbyllje depozite, në shumën prej **3.500 USD**;
- v. Po ashtu, është konstatuar se kursimet e deklaruara për vitin 2005, në shifrën prej **1.050.000 lekësh** – të përdorura si pjesë përbërëse e shumës prej 21.000 eurosh – kanë një mangësi të pjesshme të burimeve financiare, pasi, siç do të shihet edhe në vijim, nga analiza financiare rezulton se në vitin 2005 familja e subjektit të rivlerësimit del me një bilanc negativ në shumën prej 258.978 lekësh;

2.1 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

- i. Në lidhje me sa më lart, subjekti i rivlerësimit ka pohuar se: *ai – për mungesë eksperience në deklarime – nuk e ka specifikuar që shuma prej 3.500 USD ndodhej e depozituar në bankë, por ai e deklaruar si kursim vjetor shumën prej 300.000 lekësh, pa e specifikuar si cash apo si gjendje në bankë. Sipas tij bëhet fjalë për një pasaktësi, pasi nuk kishte arsye për të mos specifikuar këtë shumë.*

- ii. Në lidhje me mungesën e burimeve financiare në rastin specifik – por edhe për të gjitha vitet e tjera me bilance negative – subjekti i rivlerësimit *ka kundërshtuar metodologjinë dhe veprimet përlllogaritëse të kryera në analizën financiare*, pasi, sipas tij, *janë konsideruar shpenzime jetike shumë më të larta sesa familja e tij ka pasur në realitet*;

2.2 Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet

- i. Komisioni ka shqyrtuar dhe vlerësuar të gjithë dokumentacionin e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit lidhur me burimet financiare të përdorura për blerjen e apartamentit në fjalë, dhe veçanërisht për sa i përket shumave të marra hua nga të afërmit e tij dhe në konkluzion ka rezultuar se huadhënësit kanë konfirmuar rrethanën (e dhënies hua te subjekti), si dhe kanë qartësuar dhe provuar burimin e ligjshëm të shumave të dhëna hua⁶;
- ii. Gjithashtu, Komisioni, ka konstatuar mospërputhje midis deklaratës periodike të vitit 2004 dhe burimit të shumës prej 3.500 USD, të përdorura në shtator të vitit 2005 për pagesën në shumën prej 21.000 eurosh, si kësti i parë, për blerjen e apartamentit në fjalë. Kjo shumë rezultoi që kishte qenë e depozituar në një bankë të nivelit të dytë në vitin 2004, por që nuk ishte deklaruar nga subjekti si e mbartur në vitin 2005;
- iii. Në lidhje me sa më lart, Komisioni, vlerëson se pasaktësia (mosdeklarimi i kësaj shume) në deklarin e vitit 2004 nuk ka pasjellë asnjë pasojë, që mund ta ngarkojë subjektin me dyshimin e tentativës për të fshehur këtë pasuri. Ky konkluzion arrihet pasi vetë subjekti, disa muaj më vonë e ka përdorur shumën prej 3.500 USD, pra duke e deklaruar atë. Gjithashtu nuk vihet re asnjë dyshim mbi burimin e ligjshëm të kësaj shume pasi ajo ishte e depozituar në bankë prej vitit 2004, dhe reflekset e saj financiare, lidhur me burimin e ligjshëm financiar janë trajtuar dhe pasqyruar në vitin përkatës të analizës financiare, si më poshtë vijon.

A/3. Në lidhje me rezultatet e analizës financiare

Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni duke marrë parasysh të gjitha kundërshtimet e bëra nga z. Besnik Cani, dhe duke reflektuar disa nga pretendimet e tij, të cilat janë vlerësuar si të bazuara, ka rezultuar se familja e subjektit të rivlerësimit, ka pasur në disa vite një mungesë të burimeve financiare, për të përballuar njëkohësisht investimet dhe shpenzimet e kryera ndër vite dhe realizimin e kursimeve të deklaruara, siç është pasqyruar në tabelën që vijon. Gjithashtu janë konstatuar disa deklarime të pasakta në lidhje me të ardhurat familjare.

Analiza financiare përmblendhëse për periudhën 2003 - 2016

Viti	Të ardhurat sipas transaksioneve bankare	Pasuri, detyrime, shpenzime	Diferenca
2003	956,759	642,860	313,899
2004	1,346,622	1,004,515	342,107
2005	1,390,977	1,649,955	-258,978
2006	1,567,381	1,675,219	-107,838

⁶ Shih deklaratat noteriale të bëra nga: z. P.N., më datat 31.01.2017; 20.03.2018 dhe 27.07.2018 si dhe nga dokumentacioni me vulë apostile i paraqitur nga z. P.T. - banues në Greqi, - në lidhje me huan prej 6.000 euro që i kishte dhënë subjektit në vitin 2005;

2007	1,484,107	852,607	631,500
2008	1,746,465	1,338,796	407,669
2009	1,828,258	1,680,496	147,762
2010	2,412,118	2,592,677	-180,559
2011	3,138,741	3,262,796	-124,055
2012	3,261,700	3,029,679	232,021
2013	2,819,261	2,802,909	16,352
2014	2,972,490	2,946,342	26,148
2015	2,838,157	2,986,540	-148,383
2016	2,391,497	2,286,234	105,263
Totali	30,041,577	28,751,624	1,402,909
	Rezultojnë 5 vite me rezultat negativ për një total prej		-819,812 lekë

3.1 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me analizën financiare

- i. Në lidhje me mungesën e burimeve financiare, siç u tha edhe më lart, subjekti i rivlerësimit *ka kundërshtuar metodologjinë dhe veprimet përlllogaritëse të kryera në analizën financiare*, pasi, sipas tij, *janë konsideruar shpenzime jetike shumë më të larta sesa familja e tij ka pasur në realitet;*
- ii. *Gjithashtu, subjekti ka pretenduar se në disa vite shpenzimet familjare duhej të përlllogaritej një ulje, nga shifrat standard, të kostos së ushqimit të fëmijëve, për sa kohë ai i kishte çuar në institute parashkollore, ku ishte e përfshirë edhe dreka që ata konsumonin;*
- iii. *Po ashtu, subjekti deklaroi që, në ato vite që dalin me bilanc negativ, ai ka pasur edhe shuma të tjera gjendje cash, që për pakujdesi ai mund të mos ti ketë deklaruar të plota.*

3.2 Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet

- i. Siç u tha edhe më lart, Komisioni analizoi, vlerësoi dhe mori në konsideratë qëndrimin e subjektit, duke i pranuar dhe reflektuar të gjitha efektet e shpjegimeve bindëse⁷ në rezultatet financiare të viteve respektive.
- ii. Në lidhje me përlllogaritjen e kostos së jetesës Komisioni e vlerëson të pabazuar kundërshtimin dhe pretendimin e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, pasi rezultoni të jetë aplikuar një kosto jetese minimale dhe standarde në rang kombëtar, - siç është vepruar edhe për subjektet e tjerë - pra pa bërë diferenca dhe pa marrë parasysh ndryshimin e mundshëm midis qyteteve, për sa kohë ajo pasqyron minimalen e mbijetesës në zonat më pak të zhvilluara të vendit.
- iii. Nëse do të përlllogariteshin me shifra më reale dhe të segmentara për çdo zë: ushqimi, faturat e energjisë elektrike, të ujit, të shërbimeve televizive, interneti, pastrimi dhe mirëmbajtja e banesave dhe e autoveturave, siguracionet e ndryshme, argëttimeve të mundshme (si p.sh.: frekuentimi i restoranteve, bareve, hoteleve, udhëttimeve dhe pushimeve brenda vendit, palestrave, pishinave, aktivitete të tjera sportive me pagesë), shpenzime të mundshme mjekësore/dentare, etj., sigurisht që do të arrinin në një shumëfish të shumës simbolike të përlllogaritur nga Komisioni, - për shpenzimet jetike për çdo anëtar të familjes të çdo familje të shtresës së mesme, kudo që të kenë

⁷ Si për shembull: u përlllogaritën si të ardhura shumat e marra si bonus për kompensimin e shpenzimeve të transportit jashtë qytetit të banimit (për karburantin), në periudhat dhe në shumat e pretenduara nga subjekti; u zbritën kostot e udhëttimeve zyrtare për të cilat u provua që pagesat ishin kryer nga institucione të ndryshme; si dhe u mor në konsideratë gjendja në llogarinë/depozitën bankare në vitin 2004, prej 3.500 USD, që nuk ishte e deklaruar saktë nga subjekti etj;

- banuar, dhe natyrisht akoma më e lartë kjo shifër do të ishte nëse përlogaritjet do të bëheshin në përputhje me të dhënat INSTAT për shtresën e lartë, ku mund të futet edhe familja e subjektit;
- iv. Gjithsesi, duke u kthyer/përqendruar në një vlerësim juridiko - faktik të raportit shkak-pasojë në lidhje me problematikat e analizës financiare, si dhe duke pasur parasysh edhe qëndrimin e mbajtur në disa vendime të mëparshme të këtij Komisioni, - ndaj subjekteve të tjerë që gjendeshin në rrethana të ngjashme, trupi gjykues çmon se këto pasaktësi dhe këto **mangësi të burimeve financiare**, - për një total të akumuluar **në pesë vite** (dhe të shpërndara në harkun kohor 11-vjeçar), **në shumën prej 819.812 lekësh**, (me bilancin më negativ ndër këto 5 vite që arrin në minus **258,978** lekë, në vitin 2005), - **nuk janë të mjaftueshme që të pasjellin aplikimin e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016**, pasi vlerësimi sigurisht që duhet të kryhet nëpërmjet një analize kritike, por ai duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

B - Procesi i rivlerësimit për Kontrollin e Figurës

B/1. Mbi kontrollin e figurës:

- i. **Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK)** ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin e kontakteve të mundshme të papërshtatshme, me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin “DH” të Aneksit të Kushtetutës si dhe të ligjit nr. 84/2016.
- ii. Në konkluzion të këtyre verifikimeve, DSIK-ja ka përcjellë pranë Komisionit, një raport me shkresën e datës 27.10.2017 në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.
- iii. Sipas këtij raporti rezulton se:
- 1- *Subjekti i rivlerësimit, z. **Besnik B. Cani**, ka plotësuar saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore formularin e deklarimit për kontrollin e figurës;*
 - 2- *Subjekti ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato që janë deklaruar në deklaratën e sipërpërmendur;*
 - 3- *Nuk ekzistojnë të dhëna që subjekti i rivlerësimit të ketë kontakte të papërshtatshme;*

Si konkluzion DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit, z. Besnik Cani, për vazhdimin e detyrës.

B/2 Hetimet e kryera nga Komisioni mbi kontrollin e figurës

- i. Në vijim të disa denoncimeve nga publiku, të paraqitura pranë Komisionit, në përmbajtjen e të cilave, veç të tjerash, kishte referime;
- ii. Mbi rrethana me nuanca të akuzave korruptive dhe me aludime mbi kontratë të mundshme të subjektit me krimin e organizuar, iu kërkua organeve ligjzbatuese të riaktivizonin një procedurë verifikimesh, me qëllim verifikimin e vërtetësisë së tyre dhe, për rrjedhojë, kryerjen e rivlerësimit dhe përditësimit të kontrollit të figurës së subjektit të rivlerësimit.
- iii. Pas këtyre veprimeve verifikuese, me shkresën e datës 12 nëntor 2018, nga organet kompetente konfirmohet *mospasja e të dhënave që z. Besnik Cani të ketë kontakte të papërshtatshme*, dhe njëkohësisht konfirmohet edhe përshtatshmëria e tij, për vazhdimin e detyrës;

Pra, si konkluzion: DSIK-ja ka rikonstatuar dhe ka konfirmuar përshtatshmërinë e z. Besnik Cani, për vazhdimin e detyrës.

Për sa më lart, trupi gjykues, duke mos pasur asnjë element apo provë të kundërt ndaj konkludimeve të DSIK-së, lidhur me ekzistencën e mundshme të kontakteve të papërshtatshme me subjektin e rivlerësimit, çmon përshtatshmërinë e tij për të vijuar në detyrë.

C - Në lidhje me Aftësitë Profesionale

C/1. Mbi vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit, z. Besnik Cani.

Nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme është dërguar një raport - i hartuar nga Grupi i Punës, i ngritur pranë Prokurorisë së Përgjithshme, si organ ndihmës për vlerësimin profesional, - lidhur me të dhënat dhe aktet që janë analizuar për këtë qëllim, dhe konkretisht:

1. Formulari i vetëdeklarimit;
2. Tre dokumente ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit;
3. Pesë dosje penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
4. Dokumentacioni respektiv për sa i përket formimit profesional, trajnimeve dhe të dhënave nga burimet arkivore etj;

Grupi i Punës ka konkluduar se subjekti është vlerësuar shumë mirë për aftësitë profesionale, organizative, integritetin, etikën dhe angazhimin profesional;

Po ashtu, shumë mirë ka qenë edhe vlerësimi i bërë nga ana e Prokurorit të Përgjithshëm, përgjatë viteve 2014, 2015 dhe 2016 për subjektin e rivlerësimit mbi aftësitë e sipërpërmendura.

C/2. Hetimet e kryera nga Komisioni mbi Aftësitë Profesionale dhe Etikën

Në lidhje me çështjet e shortuara, - të sipërpërmendura si të analizuar nga Grupi i Punës pranë Prokurorisë së Përgjithshme - **Komisioni vëren se në njërin nga këto dosje janë konstatuar disa problematika**, të cilat përgjatë vlerësimit të kryer nga Grupi i Punës nuk janë evidentuar apo pasqyruar⁸ në raportin e tyre, dhe konkretisht:

- i. Për sa i përket vendimit, të subjektit të rivlerësimit, **“Për shfuqizimin e akteve të çështjes penale nr. (***)/2015”**, të datës 10 shtator 2015, Komisioni ka konstatuar se në përfundim të hetimeve, prokurori i çështjes, Xh. S., kishte vendosur: *“Gjykimin e çështjes penale nr. (***), datë 23 qershor 2015, me të pandehur shtetasin B. GJ., të akuzuar për veprën penale të ‘Kanosjes së Gjyqtarit në formën e kanosjes së Prokurorit’ të parashikuar në nenin 317 të Kodit Penal”*;
- ii. Kjo dosje, më pas, ka kaluar për kontroll tek drejtuesi i prokurorisë, pra tek subjekti i rivlerësimit, z. Besnik Cani - asokohe me funksion Drejtues i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan - i cili pasi ka kryer vlerësimin mbi: veprimet hetimore të kryera nga prokurori i çështjes; zbatimin e procedurës dhe të afateve procedurale; ligjshmërinë dhe besueshmërinë e akuzës së ngritur; konkludimet hetimore dhe kërkesën/vendimin e dërgimit në gjyq të këtij procedimi penal, ka vendosur, *“Shfuqizimin e vendimit të datës 21 korrik 2015 për dërgimin në gjyq të çështjes penale nr. (***)/2015 si dhe të kërkesës për gjykim të kësaj çështje”*;
- iii. Rezulton që vendimi për *“Pushimin e çështjes”* në fjalë - sipas arsyetimit të subjektit - është marrë nga ana e tij duke u bazuar edhe në vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë me nr. 739,

⁸ Shih dosjen nr. 2 – vendim “Për shfuqizimin e akteve të çështjes penale nr. (***)”, viti 2015;

- datë 13 dhjetor 2006, por ngelin dyshime mbi bindshmërinë e argumentimeve, nëse faktet janë vlerësuar juridikisht në mënyrë korrekte, në lidhje me ricilësimin e veprës penale, si dhe mbi përcaktimin dhe citimin e bazës ligjore të aplikueshme në rastin konkret;
- iv. Në fakt, duke analizuar këtë vendim, rezulton se vetë subjekti ka çmuar se veprimet e të pandehurit B. Gj. përbëjnë elementë të veprës penale të fyerjes. Por ai ka vlerësuar (gabimisht) se veprimet në fjalë mund të futeshin tek ato shkelje të parashikuara nga neni 119 i Kodit Penal, për fyerje (*të thjeshtë*), - veprë penale kjo që, sipas nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale, ndiqet me ankim direkt në gjykatë, nga ana e të dëmtuarit akuzues;
- v. Realisht, sipas kësaj dispozite përcaktohet se vetë i dëmtuari nga një veprë penale - në kushte të caktuara - ka të drejtë të paraqesë kërkesë në gjykatë dhe të marrë pjesë në gjykim për të vërtetuar akuzën dhe për të kërkuar shpërblimin e dëmit. Në këto raste, prokurori merr pjesë në gjykimin e këtyre çështjeve dhe sipas rastit kërkon dënimin e të pandehurit ose pafajësinë e tij. Por problemi qëndron në mosaplikimin e kësaj dispozite në rastin konkret;
- vi. Komisioni e çmon të gabuar aplikimin e nenit 119 të Kodit Penal në rastin konkret (ose ricilësimin e veprës penale), pasi gjithsesi bëhet fjalë për një veprim kërcënues/fyes apo kanosës (cilido qoftë ai) të kryer kundër një prokuroreje. Për rrjedhojë - edhe nëse nuk ka pasur element të veprës penale *kanosje*, (gjë që do të përjashtonte aplikimin e nenit 317 i Kodit Penal), konstatimi i konsumimit të veprës penale të fyerjes, - në rastin konkret, nuk mund të aplikohet neni 119 i Kodit Penal (*për fyerje e thjeshtë*), por neni 318 i Kodit Penal, pasi sigurisht (siç e pohon edhe vetë subjekti i rivlerësimit, në argumentimin e tij), jemi përballë një fyerje të konsumuar ndaj një personi me cilësinë funksionale dhe me statusin e prokurores. Pra rezulton që me aplikimin e nenit 318 të Kodit Penal, kemi të bëjmë me një veprë penale e cila duhej të vijohet/ndiqej kryesisht nga Prokuroria, dhe jo të pushoheshin hetimet;
- vii. Në konkluzion, konstatohen mangësi profesionale në moskryerjen e hetimeve të thelluara, në cilësimin korrekt të një veprë penale, si dhe në aplikimin e një baze të gabuar ligjore në rastin konkret. Kjo pasi, përtej dyshimeve mbi ekzistencën e elementeve të veprës penale të kanosjes, nga dokumentet prezentë në dosje del qartë prezenca e veprës së fyerjes – dhe kjo pohohet edhe nga vetë subjekti i rivlerësimit në arsyetimin e tij – dhe po ashtu nuk mund të injorohej fakti që personi i dëmtuar ishte me funksion prokurore. Ky fakti i fundit çon automatikisht në një tjetër cilësim veprë – gjë që nuk është bërë nga z. Besnik Cani. Për rrjedhojë është pushuar një procedim penal, i cili do të duhej të ishte vijuar dhe të çohej në gjykim, në bazë të provave të administruara gjatë hetimeve të kryera nga prokurori (titullar) i çështjes në fjalë;
- viii. Në lidhje me sa më lartë, gjatë mbrojtjes së tij, subjekti ka pohuar se për të vijuar më tej me këtë procedim penal duhej që pala e dëmtuar të kishte paraqitur shprehimisht kërkesë për ndjekjen penale të autorit të veprës në fjalë, por pa e provuar këtë rrethanë. Gjithashtu, Komisionit i rezulton që personi i dëmtuar ka paraqitur kallëzim kundër shtetasit B.Gj.;
- ix. Gjithsesi, pika kyçe në këtë vendim nuk është ekzistenca apo jo e një kërkesë nga ana e të dëmtuarës, për të shprehur vullnetin e saj për ndjekje penale të të pandehurit – në kuadrin e aplikimit të nenit 318 të Kodit Penal, por është pikërisht mospërdorimi i këtij të fundit si bazë ligjore, pasi subjekti ka konkluduar për aplikimin, në rastin konkret, të nenit 119 të Kodit Penal, dhe jo të nenit 318 të Kodit Penal;
- x. Së fundmi komisioni çmon se, - duke mbajtur parasysh faktin se gjithsesi, subjekti ka arritur, së paku, një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale - ky vendim, për pushimin e hetimeve të sipërpërmendura, - i marrë nga subjekti, njëkohësisht me shfuqizimin e

akteve të çështjes penale nr. (***)/2015, - duhet të transferohet, në bazë të pikës 4 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, pranë organit kompetent për inspektimin e shkeljes disiplinore, pasi ai është dhënë, nga subjekti, në cilësinë e drejtuesit të prokurorisë, duke ç'fuqizuar një vendim të marrë nga prokurori për të çuar çështjen në gjyq, ndërsa rezultoi se hetimet nuk kanë qenë të thelluara⁹ dhe shteruese; faktet nuk janë vlerësuar juridikisht në mënyrë korrekte; ricilësimi i veprës penale ka qenë i gabuar; përcaktimi/citimi i bazës ligjore të aplikueshme në rastin konkret ka qenë i gabuar.

D - Në lidhje me Etikën Profesionale

Komisioni vlerëson të analizojë, nën aspektin e etikës, dy rrethana që bëjnë të lindin dyshime mbi qëndrimin, qasjen dhe sjelljen e subjektit të rivlerësimit.

D/1. Në lidhje me përmbajtjen dhe interpretimin e kontratës së lidhur midis subjektit të rivlerësimit, z. Besnik Cani, dhe shoqërisë “(*)” sh.p.k., - dhe të amendamenteve të saj - si dhe mbi analizimin e efekteve dhe të pasojave të mundshme të kësaj kontrate, në përfundim të hetimit administrativ është konstatuar se:**

- i. Më datë 27.01.2016, subjekti i rivlerësimit ka nënshkruar një kontratë për dhënie me qira të truallit në P.¹⁰ në favor të shoqërisë “(***)” sh.p.k. Nëpërmjet kësaj kontrate shoqëria “(***)” sh.p.k., do të merrte me qira, për 25 vjet, truallin me sip. rreth 1.000 m² (nga të cilat 363 m² fillimisht ishin të shtetasit me initiale A. P., që më pas e shiti te subjekti, - dhe 633,9 m² ishin të vetë, z. Besnik Cani¹¹, mbi të cilin gjendeshin dy ndërtesa: njëra ishte banesa e subjektit, me sipërfaqe prej 112 m² dhe një tjetër godinë prej 52 m² në pronësi të shtetasit A.P.);
- ii. Me kontratën e mësipërme, kompania “(***)” sh.p.k., merrte përsipër edhe rrënimin, rrafshimin, transportimin e materialet e mbetura të godinave ekzistuese, marrjen e lejes për shesh ndërtimi si dhe për ndërtimin mbi të, me shpenzimet e veta, të një pike karburanti, të një lokali bar-kafe dhe të një lavazhi për automjete;
- iii. Më datë 06.01.2017, kontrata e sipërpërmendur u amendua, pasi ndërkohë z. A.P. kishte shitur pjesën e tij të truallit tek subjekti i rivlerësimit, dhe për rrjedhojë, ky i fundit ngelej palë e vetme në kontratën e lidhur me shoqërinë “(***)” sh.p.k.;
- iv. Gjithashtu, kontrata specifikonte që: *“Subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e qiradhënësit, do të përfitonte 5 lekë për çdo litër karburant të shitur, dhe njëkohësisht do të shlyej detyrimi që do të krijohet për ndërtimet, nga shoqëria “(***)” sh.p.k. që do të qiraja mujore, dhe do të arkëtojë 50 % të qerasë mujore – si kompensim mbi ndërtimet e kryera, të cilat pas 25 vitesh do të bëhen pronë e z. Besnik Cani”*;
- v. Më vonë, në sajë të hetimeve të kryera në terren nga Komisioni, rezultoi që stacioni i shitjes me pakicë të karburantit administrohej nga shoqëria “(***)” sh.p.k., - siç duket qartë nga kuponi tatimor nr. (***), datë 05.01.2018, - ndërsa lokali bar-kafe dhe lavazhi i automjeteve, pranë tij,

⁹ Për sa i përket pohimeve të rreme që i hetuari ka bërë ndaj prokurores, person i dëmtuar, në lidhje me cilësimin e tij si një OPGJ, nuk rezultoi të jetë verifikuar nëse ai realisht ishte një OPGJ apo jo, dhe nëse është bërë ky verifikim nuk rezultoi pasqyrimi i kësaj rrethane në vendim, edhe pse fillimisht kundër tij ishte ngritur edhe kjo akuzë;

¹⁰ Kontratë me nr. (***) rep., nr. (***)kol.;

¹¹ Të legalizuar/shitur nga ALUIZNI, më datën 08.06.2009;

- administroheshin nga djali i subjektit, z. E. C., i cili kishte mbushur 18 vjeç, vetëm pak kohë më parë, më datë 6 shkurt 2017;
- vi. Më tej rezultoi se z. E. C., ishte caktuar nga subjekti i rivlerësimit, si administrator i biznesit në fjalë¹², njëkohësisht me marrëveshjen e bërë me shoqërinë “(***)” sh.p.k., - pas dorëheqjes së kësaj kompanie nga e drejta kontraktuale mbi përdorimin 25-vjeçar të ambienteve të lokalit dhe të lavazhit, dhe dorëzimin/vënien në dispozicion të subjektit të rivlerësimit, të këtyre të fundit prej datës 01.04.2018;
- vii. Për sa më lart konfirmohet edhe nga shkresa e bërë nga shoqëria “(***)” sh.p.k., nr. (***)prot., datë 11.04.2018, e cila, veç të tjerash, flet për përdorimin e një zyre – ekzistuese në ambientet e shërbimit/mbështetëse të pikës së tregtimit me pakicë të karburantit – e cila nuk rezulton, në asnjë dokument të mëparshëm, të disponuar nga Komisioni^{13,4} si pjesë përbërëse e ndërtimeve të konkorduara në tokën e subjektit të rivlerësimit;
- viii. Nëpërmjet deklaratës periodike të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit konfirmon ekzistencën e marrëveshjeve të sipërcituara, dhe dorëzon pranë ILDKPIK-së dokumentacionin relativ provues;
- ix. Më datën 01.04.2017, siç u tha edhe më lartë, nëpërmjet amendamentit nr. 2 të kontratës së qirasë në fjalë, subjekti i rivlerësimit dhe shoqëria “(***)” sh.p.k., bien dakord që të ndryshojnë pikën 5.8 të kontratës së datës 27.01.2016 (të sipërpërmendur) si vijon: *“Qiramarrësi heq dorë nga e drejta e ushtrimit të aktivitetit të tregtimit dhe përdorimit të lokalit dhe të lavazhit duke ia kaluar këtë të drejtë qiradhënësit...”*;
- x. Pra, subjekti i rivlerësimit, pasi kishte përfituar të drejtën e përdorimit të lokalit dhe lavazhit, kishte caktuar/çuar djalin të vet, z. E. C., për të menaxhuar këtë aktivitet, i cili për këtë arsye, në datën 27.03.2017, ka hapur një NIPT, si person fizik, me aktivitet, *Bar-kafe lavazh, tregti me pakicë të produkteve ushqimore dhe cigare*;
- xi. Por ndërkohë, Komisionit i rezultoi se z. E. C. njëkohësisht po ndiqte/ndjek studimet në Vjenë, bashkë me vëllain e tij. Ai prej muajit qershor 2017 jeton në Vjenë të Austrisë;
- xii. Gjithashtu, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, me shkresën e datës 13.04.2018, komunikon se biznesi i z. E. C., pra aktiviteti i bar-kafe e lavazh, përgjatë periudhës prill - dhjetor 2017, ka pasur një qarkullim prej 4.408.300 lekësh dhe një fitim neto në vlerën 1.574.919 lekë. Këto shifra konfirmohen edhe nga deklaratimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit, për vitin 2017;
- xiii. Ndërsa, nga ana tjetër, subjekti i rivlerësimit, ka përfituar nga shitja e karburantit të pikës “(***)” në P., shumën neto prej 2.580.316 lekësh në vitin 2017 dhe shumën neto prej 846.316 lekësh për periudhën janar - qershor 2018. Këto shifra duhet të konsiderohen të dyfishuara nëse konsiderojmë faktin që, një sasi e barabartë me ato, që është derdhur në llogarinë e subjektit të rivlerësimit, është mbajtur nga shoqëria “(***)” sh.p.k., për rimbursimin gradual të investimit të kryer prej saj, për ndërtimet e sipërcituara, - në zbatim të pikës 4 të amendamentit të kontratës së përmendur më lart, më datë 06.01.2017;
- xiv. Më datë 25 tetor 2018, ONM-ja¹⁴ ka përcjellë pranë Komisionit një opinion, bazuar në nenin “B”, pika 3, të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 49, pika 11, të ligjit nr. 84/2016;

¹² Nëpërmjet aktmarrëveshjes së bërë, më datë 01.04.2016, midis z. Besnik Cani dhe “(***)” sh.p.k.;

¹³ Ndërtimi dhe ekzistenca e një zyre në stacionin e karburantit nuk rezulton të deklaruar asgjëkund: as në kontratën e qirasë dhe as në modifikimet e mëtejshme të saj; as në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit dhe as në dokumentet e nisura nga shoqëria “(***)” sh.p.k.;

¹⁴ Organizata Ndërkombëtare e Monitorimit.

- xv. Në sajë të një analize të përgjithshme të përmbajtjes së kontratës së mësipërme dhe të amendimeve të mëpasshme të saj, si dhe duke marrë parasysh edhe opinionin e ONM-së, Komisioni ka konstatuar se:
- xvi. Kontrata në fjalë nuk mund të konsiderohet një kontratë qiraje¹⁵ pasi ajo nuk i përmban elementët përbërës të një kontrate qiraje¹⁶, të parashikuar nga Kodi Civil¹⁷;
- xvii. Kontrata e qirasë, ka një afat 25-vjeçar, me kushtin që në përfundim të saj, automatikisht kryhet kalimi i pronësisë mbi sendet e paluajtshme të ndërtuara nga qiramarrësi;
- xviii. Këto elemente, të para së bashku me amendamentet e mëpasshme, prodhojnë efekte të shumëfishta dhe të ndryshme nga një kontratë e mirëfilltë qiraje - edhe pse formalisht ndërveprimet kontraktore në fjalë janë veshur me termin dhe me petkun juridik të kontratës së qirasë¹⁸;
- xix. Marrëdhënia juridike midis subjektit dhe shoqërisë “(***)” sh.p.k. mund të duket si një pjesëmarrje *de facto* në një shoqëri të thjeshtë¹⁹, ku secila palë sjell një send apo kryen një investim dhe pastaj fitimet ndahen nga ortakët, sipas marrëveshjes së bërë midis tyre, dhe për rrjedhojë subjekti përfiton shuma në varësi të realizimit të fitimeve nga shoqëria në fjalë, pra falë mbarëvajtjes së biznesit, dhe jo si një detyrim kontraktor për të paguar një qira mujore me një shifër monetare të paracaktuar dhe fikse;
- xx. Pranimi i të drejtës së përdorimit të ambienteve, krijimi dhe administrimi i një biznesi të tillë, - si dhe mënyra se si është kontraktuar/formalizuar dhe menaxhuar e gjithë situata, që ka prodhuar dhe prodhon efekte të përfitimeve financiare të ndërthurura brenda familjes së subjektit të rivlerësimit, mund të krijojë dyshime mbi një përfitim nga pozicioni funksional/profesional i z. Besnik Cani;
- xxi. Sa më lart, mund të jetë një shkak papajtueshmërie me profesionin e prokurorit dhe/ose mund të përbëjë një konflikt interesi²⁰ në sajë të Urdhrit nr. 141, të Prokurorit të Përgjithshëm, datë 19 qershor 2014, si dhe mund të konsiderohet si një mosrespektim i kufizimeve të parashikuara nga ligji nr. 96/2016, - *Për statusin e gjyqtareve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, dhe specifikisht neni 7, mbi kufizimet për shkak të funksionit.*
- xxii. Gjithashtu, kjo rrethanë komplekse mund të jetë shkak për cenimin e etikës profesionale dhe për humbjen e besimit të publikut tek figura e një prokurori të Republikës së Shqipërisë.
- xxiii. Në lidhje me sa më lart Komisioni paraqiti një kërkesë pranë ILDKPKI-së për analizimin e marrëdhënies juridike në fjalë midis subjektit dhe shoqërisë “(***)” sh.p.k.;
- xxiv. ILDKPKI-ja, me shkresën e datës 27.04.2018, shprehet se, pasi ka analizuar deklaratimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit si dhe dokumentacionin që lidhet me marrëdhënien tregtare me shoqërinë “(***)” sh.p.k., nuk konstaton ekzistencën e ndonjë konflikti interesash për shkak të funksionit për z. Bashkim Cani;

¹⁵ Neni 801 i Kodit Civil parashikon detyrimin e qiramarrësit që të japë një shpërblim të caktuar, kundrejt gëzimit të përkohshëm të një sendi. Në rastin konkret kjo nuk qëndron, pasi nëse për një periudhë të caktuar kohore, për çfarëdo lloj shkak, nuk do të punonte pompa e benzinës, në këtë segment kohor, z. B. Cani, nuk do të merrte asnjë lloj shpërblimi, edhe pse shoqëria “(***)” do të vijonte të gëzonte sendin në posedim;

¹⁶ Këtë fakt e ka pohuar dhe pranuar edhe vetë kompania e “(***)” sh.p.k., pasi në shkresat e saj ajo sqaron që më shumë sesa një kontratë qiraje, bëhet fjalë për një formë bashkëpunimi të bazuar në të drejtën civile/tregtare ndërkombëtare dhe që i ngjan më shumë tipologjisë së kontratave PPP-së, të stimuluar nga shteti me partnerë privat, (pra në investime të caktuara afatgjate – me interes dhe përfitim reciprok);

¹⁷ Shih edhe opinionin e ONM-së (aneksi i bashkëlidhur) mbi këtë pikë;

¹⁸ Shih pikat 12/13/14 me sipër (këtu në footnote).

¹⁹ Neni 1074 i Kodit Civil.

²⁰ Në lidhje me ekzistencën e mundshme të konfliktit të interesit në këtë rast, Komisioni ka kërkuar një vlerësim nga ILDKPKI-ja, që më shkresën nr. (***)prot., datë 27.04.2018, është përgjigjur se në kuptimit e ligjit të aplikueshëm nga ky institucion, nuk shihet prania e një konflikti interesi në rastin konkret të z. B. Cani;

- xxv. Së fundmi, Komisioni ka hetuar edhe mbi ekzistencën e mundshme të ndonjë procedimi penal ndaj pronarëve, administratorëve, ortakeve ose funksionarëve të shoqërisë “(***)” sh.p.k., të shqyrtuar në prokuroritë ku mund të kishte kryer hetime, z. Besnik Cani, ose ku ai kishte ushtruar funksionin e drejtuesit, pa u konstatuar një gjë të tillë;

1.1 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me kontratën në fjalë

Subjekti i rivlerësimit, në lidhje me këtë kontratë, pasi u njoh me dyshimet e shprehura nga Komisioni mbi këtë çështje, ka paraqitur shpjegimet, parashtrimet dhe konkluzionet e veta, - të bashkëngjitura me dokumentacion mbështetës, - duke pohuar se:

- i. *Në vitin 2016, ai ishte kontaktuar nga shoqëria “(***)” sh.p.k., e cila kishte shprehur interesin e ndërtimit të një pike karburanti në P., meqenëse edhe terreni përbri rrugës kryesore, që posedohej nga subjekti, ishte i përshtatshëm;*
- ii. *Këtë propozim ai e kishte konsideruar si një okazion të mirë për të realizuar dëshirën/ëndrrën e tij për të mundësuar shkollimin e fëmijëve të tij jashtë shtetit, duke qenë se nuk kishte mundësi ekonomike për ta përballuar vetë këtë projekt;*
- iii. *Ideimin dhe hartimin e kontratës së propozuare kishte kryer departamenti juridik i shoqërisë “(***)” sh.p.k., pasi ato ishin kushte të paracaktuara prej saj dhe subjekti nuk kishte kurrsesi fuqi negociimi për ti ndryshuar apo për ti imponuar ato kushte tek një kompani kaq e madhe²¹;*
- iv. *Marrja në përdorim e lokalit dhe e lavazhit ka ardhur si pasojë e mungesës së interesit nga ana e shoqërisë “(***)” sh.p.k., për ti shfrytëzuar ato, pasi kjo shoqëri e mbështet politikën e vetë të biznesit në tregtimin e hidro-karbureve dhe jo në menaxhimin e lokaleve bar-kafe apo të lavazheve;*
- v. *Ai asnjëherë nuk ka pasur dhe nuk ka për qëllim të krijojë një shoqëri të thjeshtë, apo të çfarëdolloj tipi, me kompaninë në fjalë, por thjeshtë ka pranuar dhe ka firmosur një kontratë të përpiluar dhe të cilësuar si një marrëdhënie qiraje nga shoqëria “(***)” sh.p.k., dhe në lidhje me këtë kualifikim/emërim kontratash qiraje (me çmim të shprehur në lekë për litër), ka paraqitur dokumente mbështetëse, - specifikisht një sërë kontratash qiraje me objekt të ngjashëm, të lidhura nga shoqëri të ndryshme me persona të tretë;*
- vi. *Nga ana tjetër, shoqëria “(***)” sh.p.k., e pyetur nga Komisioni, ka paraqitur shpjegime, me të cilat, veç të tjerash ka konfirmuar që kontrata në fjalë është përpiluar nga departamenti i tyre juridik, si dhe ka pranuar dhe pohuar që, edhe pse marrëveshja në fjalë është quajtur kontratë qiraje, ajo është atipike dhe bazohet kryesisht në të drejtën private ndërkombëtare;*
- vii. *Po ashtu shoqëria “(***)” sh.p.k., ka vënë në dispozicion të Komisionit bilancet e veta për sa i përket pikës së karburantit që është objekt i kontratës në fjalë si dhe disa kontrata të tjera qiraje të lidhura nga ajo me të tretë, me objekt të ngjashëm;*
- viii. *Veç të tjerash, shoqëria “(***)” sh.p.k., duke argumentuar tipologjinë e kontratës së “qirasë” me çmim të përllogaritshëm me lekë për litër, është shprehur se ajo aplikon një politikë biznesi me pikësynim përfshirjen e palëve të tjera kontraktuese në marrjen e një pjese të risqeve të biznesit;*
- ix. *Gjithashtu, subjekti ka pohuar dhe pretenduar se ai nuk ka pasur asnjëherë ndonjë konflikt interesi me pronarët apo drejtuesit e shoqërisë “(***)” sh.p.k., pasi këta të fundit nuk kanë pasur asnjë*

²¹ Pretendimet se hartimi i kontratës së propozuar ishte kryer nga departamenti juridik i shoqërisë “(***)” sh.p.k., dhe që kushtet e parashikuara në të ishin të paracaktuara prej saj, në përputhje me interesat e kompanisë, janë konfirmuar edhe nga vetë shoqëria “(***)” sh.p.k., nëpërmjet shkresës së saj, të sipërpërmendur;

*procedim në rrethet gjyqësore (dhe në vitet përkatëse) ku ai ka kryer funksionin e prokurorit apo të drejtuesit të prokurorive*²²;

- x. *Ai nuk ka menduar ndonjëherë dhe nuk mendon se kjo kontratë mund të ketë ndikuar apo të ndikojë në profesionin e tij, pasi ajo është një kontratë ligjore dhe e deklaruar edhe pranë ILDKPKI-së, dhe ky institucion ka konfirmuar rregullsinë e kësaj marrëdhënie kontraktore dhe mungesën e konfliktit të interesave;*
- xi. *Po ashtu, subjekti deklaroi që, nëse ai do të kishte dyshime mbi mospërputhshmërinë e kësaj kontrate me funksionin e tij si prokuror, nuk do ta kishte nënshkruar kurrë atë, madje ai shtoi se ishte i gatshëm që ta zgjidhte menjëherë atë kontratë nëse ajo do të çmohej si një pengesë për ushtrimin e funksionit të tij, apo si burim i një konflikti interesash.*

1.2 Arsytimi ligjor në lidhje me efektet e kontratës në analizë

Komisioni, pas një vlerësimi të përmbajtjes së kontratës së sipërcituar, të amendimeve të mëpasshme të saj, të efekteve që kontrata në fjalë ka prodhuar, që po prodhon dhe që do të prodhojë, të rrethanave në të cilat është konkretizuar dinamika e evoluimit të marrëdhënies kontraktuale midis, z. Besnik Cani, dhe shoqërisë “(***)” sh.p.k., si dhe duke marrë parasysh edhe opinionin e ONM-së, Komisioni vlerëson se:

- i. Për sa i përket emërimit të kontratës objekt analize, trupi gjykues, edhe në sajë të sa është shprehur më lart, termi “kontratë qiraje” është i papërshtatshëm dhe jo koherent me përmbajtjen dhe me efektet që prodhon kontrata në fjalë, por kjo nuk e ngarkon automatikisht me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit. Ky konkluzion arrihet jo vetëm për faktin që palët kanë pohuar se kontrata është hartuar nga departamenti juridik i shoqërisë “(***)” sh.p.k., dhe i është ofruar z. Besnik Cani me kushtet e paracaktuar prej saj, por kryesisht për rrethanën e provuar nëpërmjet një sërë kontratash - të lidhura nga shoqëri të ndryshme²³ me të tretë - të emëtuara edhe ato si “kontrata qiraje” dhe me një objekt të ngjashëm, ku “pagesa e qirasë bëhet me lekë për litër”. Sa më lart e përjashton hipotezën se subjekti i rivlerësimit mund të ketë lidhur një kontratë të emëruar “qiraje” me qëllim që të fshehte efektet reale të saj²⁴ - edhe pse të ndryshme nga ato që prodhon një kontratë e mirëfilltë qiraje;
- ii. Trupi gjykues nuk e konsideron reale dhe të provuar praninë e elementeve formale dhe substanciale që mund të na çojnë në konkluzionin se ekziston një shoqëri e thjeshtë midis subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë “(***)” sh.p.k., pasi, - përtej faktit që një gjë e tillë nuk rezulton e formalizuar, - kjo e fundit është një kompani shumë e madhe me një shtrirje mbarë kombëtare dhe që ka bilancet e veta të përgjithshme, ku përfshihet edhe aktiviteti i pikës së karburantit në P.. Por kjo nuk do të thotë që të mohohet se marrëdhënia kontraktuale ka efekte të ngjashme me të, në lidhje me pjesëmarrjen në risqe dhe në shpërndarjen e fitimeve - rrethanë kjo që do të vlerësohet më poshtë;
- iii. Në lidhje me prezencën e një konflikti interesash të mundshëm, që mund të lindin për, z. Besnik Cani, në sajë të marrëdhënies kontraktore me shoqërinë “(***)” sh.p.k., bazuar edhe në

²² Kjo rrethanë është e provuar nga dokumentacioni përkatës i paraqitur nga subjekti, por gjithashtu këto verifikime që i kishte kryer paraprakisht edhe Komisioni – siç është shprehur më lart;

²³ Kontrata të lidhura jo vetëm nga shoqëria “(***)” sh.p.k. por edhe nga shoqëria G. sh.p.k. me persona të tretë që kanë dhënë me qira terrene apo edhe pika karburanti, të ndërtuara nga vetë ata;

²⁴ Efekte të cilat ai vetë i ka deklaruar pranë ILDKPKI-së, me pasqyrim integral dhe të shoqëruar me të gjithë dokumentacionin mbështetës;

- konkluzionet e arritura nga ILDKPKI-ja²⁵ si dhe të hetimeve të kryera nga Komisioni mbi çështje të mundshme të shqyrtuara apo të mbikëqyrura nga ana e subjektit, mbi persona të përfshirë në pronësi apo administrim të shoqërisë “(***)” sh.p.k., trupi gjykues çmon se nuk ka pasur një konflikt interesash;
- iv. Gjithsesi, Komisioni, vlerëson se marrëdhënia kontratuale ekzistuese midis subjektit dhe shoqërisë “(***)” sh.p.k., - që i ka mundësuar atij krijimin e një përfitimi “qiraje” të ndryshëm²⁶ dhe të përcaktueshëm, muaj pas muaji, në përpjesëtim me xhiron e biznesit të kompanisë, përfshirë këtu edhe mënyrën e përfitimit dhe të administrimit të lokalit bar-kafe dhe të lavazhit, - ka prodhuar dhe po prodhon efekte të përfitimeve financiare të ndërthurura brenda familjes së subjektit të rivlerësimit që mund të krijojë dyshime mbi një përfitim nga pozicioni funksional/profesional i z. Besnik Cani;
- v. Gjithashtu trupi gjykues çmon se sa më lart, mund të jetë shkak papajtueshmërie me funksionin e prokurorit dhe/ose mund të përbëjë një konflikt interesi²⁷ në sajë të Urdhrit nr. 141, të Prokurorit të Përgjithshëm, datë 19 qershor 2014, si dhe mund të konsiderohet si një mosrespektim i kufizimeve të parashikuara nga ligji nr. 96/2016, - *Për Statusin e Gjyqtareve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, dhe specifikisht neni 7, mbi kufizimet për shkak të funksionit*;
- vi. Në lidhje me dy pikat e mësipërme, trupi gjykues vlerëson se, duke pasur parasysh faktin se edhe në rast të një konkludimi mbi prezencën e shkaqeve që të çojnë në përgjegjësinë e subjektit të rivlerësimit, jo automatikisht mund të konsiderohet i aplikueshëm neni 61 apo pika “c” e nenit 58²⁸ të ligjit nr. 84/2016 dhe duke e kombinuar këtë rrethanë me mundësinë e shqyrtimit të saj nga një tjetër organ, - i cili do të ketë në dispozicion një gamë më të gjerë masash të mundshme, të përshkallëzuara dhe të aplikueshme në një raport më të drejtë me peshën dhe me rëndësinë e rastit, deri në shkarkim nga detyra të subjektit, - për rrjedhojë çmohet më e ekuilibruar zgjedhja për transferimin e kësaj çështje, në bazë të pikës 4 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, pranë organit kompetent për inspektimin e shkeljes disiplinore, dhe caktimin e një mase në përputhje me parimin e proporcionalitetit;

D/2. Mbi përfitimin e statusit të familjes së pastrehë

- i. Gjatë hetimit administrativ, Komisioni, mori dijeni mbi një artikull të publikuar nga portali “Pamfleti”, më datë 10 shtator 2018, i cili i referonte që: *“Subjekti i rivlerësimit kishte përfituar një kredi të butë, të marrë në emër të bashkëshortes së subjektit, pa plotësuar kriteret ligjore. Gjithashtu, në këtë artikull përshkruhej fakti se gjatë procedurës administrative për fitimin e statusit të pastrehë subjekti i rivlerësimit, z. Besnik Cani, kishte tentuar mbylljen dhe kishte shkaktuar zvarritjen e hetimeve të një procedimi penal, të regjistruar në Prokurorinë e Rrethit Fier, kundër ish-kryebashkiakut dhe disa anëtarëve të Këshillit Bashkiak Fier – (asokohe në detyrë), të cilët ishin të përfshirë në një skemë falsifikimi lidhur me dhënien e shtëpive me qira të butë, pikërisht për persona që nuk plotësonin kriteret ligjore”;*

²⁵ Të shprehura nëpërmjet, shkresës së datës 27.04.2018;

²⁶ Që përlllogaritet me 5 lekë për çdo litër të karburantit të shitur nga shoqëria “(***)” sh.p.k.;

²⁷ Edhe pse në lidhje me ekzistencën e mundshme të konfliktit të interesit në këto rrethana, ILDKPKI-ja, me shkresën nr. (***)prot., datë 27.04.2018, është shprehur se në kuptimit e ligjit të aplikueshëm nga ky institucion, nuk shihej prania e një konflikti interesi në rastin konkret të z. Besnik Cani;

²⁸ I cili pretendon mosarritjen e një niveli minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, për aplikimin e masës së shkarkimit nga detyra të Subjektit të rivlerësimit;

- ii. Pas hetimeve të kryera nga Komisioni mbi këtë rrethanë, të pasqyruar në artikullin e sipërcituar, u mundësua disponimi në rrugë zyrtare, nga Bashkia Fier, i vendimit nr. 14, të Këshillit Bashkiak Fier, i datës 28 mars 2013, "*Për miratimin e listës së familjeve të pastrehe, që do të përfitonin nga programi social i kredive të buta, të lehtësuara nga Shteti*", - por jo i dosjes së praktikës në fjalë, pasi ajo nuk disponohej më nga ky institucion;
- iii. Sipas këtij vendimi, rezultonte se bashkëshortja e subjektit, znj. L. C., realisht kishte aplikuar dhe rrjedhimisht e kishte përfituar **statusin e familjes së pastrehë**, që do të thotë se ajo - sipas organit vendimmarrës - i kishte përmbushur kriteret dhe mund të hynte në një nga kategoritë e veçanta sociale, të parashikuara nga dispozitat ligjore në fuqi, dhe konkretisht nga ligji nr. 9232, datë 13.04.2004, "*Për Programet Sociale për Strehimin e Qytetarëve në Zonat Urbane*";
- iv. Komisioni, ngriti dyshime të arsyeshme mbi plotësimin, asokohe, nga ana e familjes së subjektit të rivlerësimit, të kriterëve të përcaktuara në ligjin nr. 9232/2004 si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 600, të datës 12 shtator 2007, i ndryshuar, *mbi trajtimin e strehimit të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe funksionarëve politikë*;
- v. Në vijim, nga korrespondenca që Komisioni ka pasur me Bashkinë Fier, ka marrë dijeni që zonja L. C. në fund e sipër nuk e ka përfituar kredinë e butë;
- vi. Ky fakt është konfirmuar edhe nga Institucioni Financiar që menaxhonte fazën përfundimtare të çeljes së kredive të buta;
- vii. Po ashtu, në sajë të përditësimit të hetimeve të kryera nga Komisioni, pas njohjes me përmbajtjen e artikullit të sipërcituar, rezultoi se zonja L. C. nuk ishte (dhe as më parë nuk kishte qenë) palë blerëse e ndonjë apartamenti me kredi të butë, madje ajo nuk rezultonte as si pronare e ndonjë pronësie të paluajtshme të regjistruar në emrin e saj, pavarësisht mënyrës dhe kohës së blerjes²⁹.

2.1 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me marrjen e statusit të familjes së pastrehë.

Subjekti i rivlerësimit, pasi u njoh me rezultatet e komunikuara nga Komisioni, ka paraqitur shpjegime të detajuara dhe dokumente mbështetëse³⁰, dhe konkretisht ai ka pohuar që:

- i. Kërkesa për statusin e pastrehë është paraqitur nga bashkëshortja, e shtyrë nga dëshira për të kryer transferimin e të gjithë familjes në qytetin e Fierit, me qëllim mundësimin e një prezence më të madhe të kryefamiljarit në familje – gjë që mund të realizohej duke banuar në qytetin ku ai punonte;
- ii. Në kërkesën në fjalë nuk është bërë asnjë referim ligjor dhe znj. L. C., nuk kishte njohuri juridike për të vlerësuar cila mund të ishte baza/referimi ligjor dhe çfarë kriteresh duhej të plotësoheshin, sipas ligjit nr. 9232/2004, për dhënien/njohjen e statusit të familjes të pa strehë, të kërkuar;
- iii. Kredia e butë nuk është dizbursuar, pasi pas transferimit të subjektit në Shkodër, ai e ka ftuar bashkëshorten që të bllokonte procedurën, edhe pse ata e kishin ende rezidencën në Fier;
- iv. Subjekti ka pohuar dhe ka provuar me dokumentacion përkatës se për vitin 2013, - kur është paraqitur kërkesa për statusin e pastrehë, - nuk kishte fonde në buxhetin e Prokurorisë së Përgjithshme, të alokuara për dhënien e kredive të buta, për strehimin e prokurorëve të pastrehë;

²⁹ Me përjashtim të bashkëpronësive ligjore me bashkëshortin;

³⁰ Vendim mosfillimi të marrë nga Prokuroria e Rrethit Durrës në lidhje një kallëzim të bërë mbi këtë rrethanë; deklaratë noteriale të ish-kryebashkiakut të Fierit (asokohe), deklaratë të bashkisë Fier që nuk kishte në posedim dosjen mbi praktikën e kërkesës dhe dhënies së statusit të pastrehë etj;

- v. Gjithashtu subjekti ka pohuar se asokohe kishte një qasje të përgjithshme nga ana e bashkive për të trajtuar me kredi të buta edhe prokurorët e pastrehë, dhe përgjegjësia mbi bazën ligjore që përdorej në vendimet bashkiake, si dhe mbi kontrollin e plotësimit apo jo të kritereve, është e bashkisë vendimmarrëse dhe jo e aplikuesve;
- vi. Nuk ka qenë qëllimi apo dëshira e subjektit të përfitonte një trajtim (të pamerituar) me kredi të butë, dhe nëse ai do të kishte pasur këtë lloj qasje mund të kishte tentuar apo të kishte përfituar atë në qytetet e tjera - Shkodër dhe Elbasan - ku ai kishte pasur funksionin e drejtuesit të prokurorive të këtyre rretheve;
- vii. Subjekti ka deklaruar, dhe ka depozituar dokumentacion provues, në lidhje me faktin se ka pasur të paktën edhe një rast të një prokurori tjetër, (D. P.), që ka përfituar një kredi të butë në vitin 2011, nëpërmjet statusit të pastrehë, të njohur/dhënë nga Këshilli Bashkiak Laç, i cili është kualifikuar nga Komisioni;
- viii. Ekzistenca e një procedimi penal në Prokurorinë Rrethit Fier, që subjekti drejtonte, kundër kryebashkiakut nuk ka pasur asnjë lidhje apo ndikim në marrjen e statusit të pastrehë, dhe kjo është pohuar edhe nga vetë ish-kryebashkiaku i Fierit, - i cili ndërkohë është deklaruar i pafajshëm - nëpërmjet një deklarate noteriale;
- ix. Nuk mund të konsiderohet si një përgjegjësi në kryerjen detyrës së subjektit, sjellja e personit të lidhur, pasi iniciativa ka qenë e saj dhe nuk ka pasur asnjë ndikim, përfitim nga funksioni i tij apo paligjshmëri;
- x. Dyshimet mbi influencim të mundshëm të subjektit për shkak të pozicionit profesional, në vendimmarrjen e Këshillit Bashkiak Fier, janë shuar nga: vendimi i mosfillimit të procedimit penal, në lidhje me kallëzimin e bërë pikërisht mbi këtë rrethanë; deklarata noteriale e ish-kryebashkiakut të Fierit; fakti që edhe bashki të tjera kanë pasur këtë qasje dhe kanë njohur statusin e pastrehë edhe familjeve të prokurorëve të tjerë, të cilët – ndryshe nga rasti konkret – e kanë përfituar kredinë e butë; në rezultatet hetimit përshkruhet mungesa e provave për influencim ose ndikim të paligjshëm, nga ana e subjektit, në vendimmarrjen e Këshillit Bashkiak Fier.

2.2 Arsyetimi ligjor në lidhje me marrjen e statusit të pastrehë

- i. Pas shqyrtimit të bazës juridike të Vendimit të Këshillit Bashkiak Fier, nr. 14/2013 "*Për miratimin e listës së familjeve të pastrehe, që do të përfitonin nga programi social i kredive të lehtësuara nga Shteti*", Komisioni, vlerëson se fakti që bashkëshortja e subjektit, ka aplikuar për të përfituar një kredi të butë, sipas dispozitave ligjore jo të aplikueshme, në rastin konkret, krijon dyshimin e arsyeshëm se është përdorur funksioni dhe pozicioni i bashkëshortit në atë qytet si drejtues i Prokurorisë së Rrethit Fier, për të fituar privilegje dhe rrjedhimisht, ky veprim mund të bjeri ndesh me etikën e magjistratit dhe të ketë cenuar figurën e magjistratit si dhe besimin e publikut në sistemin gjyqësor;
- ii. Gjithsesi, sa më lart ngel për tu vlerësuar në gamën e dyshimit të arsyeshëm, nga momenti që mungojnë provat konkrete, nëpërmjet të cilave mund të lidhet, fillimisht, tentativa për të përfituar apo përfitimi³¹ i një kredie/statusi, me ekzistencën e një ndikimi të paligjshëm, dhe, më pas, kjo të ndërthuret me autorësinë e ndikimit të mundshëm të subjektit. Përkundrazi, siç u përmend edhe më lart, subjekti ka paraqitur prova të kundërta, të cilat edhe pse nuk i shuajnë dyshimet e

³¹ Tentativa/objektivi ishte kredia e butë që nuk është marrë, ndërsa "përfitimi" konsiston në marrjen e statusit të familjes së pastrehë, në mungesë të kritereve ligjore. Përfitim ky që gjithsesi ngelet pa pasoja, pasi nuk është konkretizuar qëllimi përfundimtar (i marrjes së kredisë së butë);

- arsyeshme, së paku ato e zbehin hipotezën e përfitimit nëpërmjet influencimit dhe ndikimit të paligjshëm të subjektit, për shkak të detyrës, në vendimmarrjen e Këshillit Bashkiak Fier³², duke e çuar konkludimin e Komisionit mbi këtë pikë drejt paprovueshmërisë;
- iii. Dyshimet e Komisionit konsistojnë në besueshmërinë e argumentimit të paraqitur nga subjekti lidhur me mospasjen dijani dhe me mospërfshirjen (substanciale) të z. Besnik Cani në paraqitjen e kërkesës nga ana e bashkëshortes së tij, për përfitimin e statusit të familjes së pastrehë, pa i plotësuar kriteret ligjore, me qëllim marrjen e një kredie të butë nëpërmjet një kanali procedural dhe nga fonde të destinuara për adresimin e kërkesave të familjeve në nevojë, që mund të ishin në kushtet e parashikuara nga dispozitat ligjore në fuqi, për të mundësuar futjen e tyre në programet sociale;
- iv. Gjithashtu, Komisioni e konsideron si një detyrim profesional dhe moral, për çdo subjekt, që të përkujdesen dhe të analizojnë paraprakisht çdo sjelljeje, veprim apo mosveprim, të vetin apo të personave të lidhur, që ato të mos cenojë etikën e tyre dhe besimin e publikut tek figura e magistratit apo në sistemin e drejtësisë në Shqipëri.
- v. Në lidhje me këtë aspekt, Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit, minimalisht, ka munguar në përmbushjen e detyrimit të sipërcituar, duke lënë shkas për dyshime apo humbje besimi mbi etikën e tij profesionale. Ky vlerësim përforcohet më shumë nëse mbahet parasysh edhe hipoteza mediatike³³ sipas të cilës subjekti i rivlerësimit ka përfituar nga pozicioni i tij³⁴, madje duke ushtruar një ndikim të paligjshëm në aktivitetin e Këshillit Bashkiak Fier, falë funksionit të tij, nëpërmjet një trajtimi favorizues - të vendimmarrësve të VKB-së, nr. 14/2013, një pjesë e të cilëve, asokohe, ishin persona nën hetim pikërisht nga Prokuroria e Rrethit Fier;
- vi. Në sajë të argumentimeve të mësipërme, si dhe duke pasur parasysh arsyet e shprehura më lart,³⁵ Komisioni vlerëson se ky fakt, në mungesë të provave ndërlidhëse me një ndikim të paligjshëm mbi Këshillin Bashkiak ose/dhe përfitim nga funksioni i drejtuesit të Prokurorisë, nuk mund të çojë në aplikimin e pikës 1, germa“c”, të nenit 58, të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë trupi gjykses çmon se edhe kjo rrethanë, në bazë të pikës 4, të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, duhet të përcillet pranë organit kompetent për inspektimin e shkeljes disiplinore, për një vlerësim në harmoni me dyshimet e tjera profesionale dhe caktimin e një mase të mundshme, në përputhje me parimin e proporcionalitetit;

E – Në lidhje me denoncimet e paraqitura nga publiku për subjektin e rivlerësimit, z. Besnik Cani

E/1. Denoncim i paraqitur nga shtetasi N. K.

Në denoncimin e tij, shtetasi N. K. ngre çështje korrupsioni, kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, shkelje të etikës profesionale ndaj subjektit të

³² Konkretisht për vendimit nr. 14, të Këshillit Bashkiak Fier, të datës 28 mars 2013, "Për miratimin e listës së familjeve të pastrehe, që do të përfitonin nga programi social i kredive të buta, të lehtësuara nga Shteti";

³³ Hipotezë e cila ndonëse ngelet e paprovuar në aludimet dhe konkluzionet e saj, gjithsesi ka marrë shkas nga disa fakte reale - mes tyre edhe marrja e statusit të pastrehë në një moment të caktuar dhe pa përmbushur kriteret ligjore, rrethanë kjo që mund të duhej të ishte evituar nga subjekti i rivlerësimit;

³⁴ Sipas artikullit të sipërcituar aludohej në një shkëmbim favoresh: nga një anë z. Cani ofronte një trajtim favorizues në hetimet që po kryente Prokuroria e Fierit - e drejtuar pikërisht nga subjekti i rivlerësimit - ndaj kryebashkiakut dhe disa Këshilltareve bashkiak, të cilët njëkohësisht ishin si në cilësinë e personave nën hetim por edhe në atë të vendimmarrësve të VKB Fier nr. 14/2013, nëpërmjet të cilit i njihet statusi i pastrehë edhe familjes së z. B. Cani;

³⁵ Në konkluzion të kap. 1/D, paragrafi 1.2, pika vi;

rivlerësimit, por pa bashkëngjitur dokumentacion provues të implikimit konkret të subjektit të rivlerësimit, z. Besnik Cani;

E/1-bis. Shtetasi N.K. ka paraqitur një tjetër denoncimin.

Edhe në denoncimin e dytë, denoncuesi i referohet të njëjtës çështje, duke pretenduar se subjekti i rivlerësimit e kishte thirrur atë, në praninë e prokurorit titullar të dosjes/çështjes, dhe e ka ftuar të paguante një shumë të caktuar (gjobe), për të mbyllur çështjen e tij, përndryshe do të çohet në Gjykatë. Veç të tjerash, në këtë denoncim ai zgjerohet me shpjegime të tjera shtesë duke kundërshtuar vendimin e Gjykatës (që e ka dënuar) si dhe veprimet hetimore të kryera nga prokuroria.

Në sajë të këtij denoncimi, Komisioni kërkoi, të administrojë dhe të studiojë dosjet që i përkisnin procedimit penal të nisur kundër denoncuesit N.K., nga ku u vërejt se:

- i. Duke analizuar dokumentacionin e dosjes gjyqësore për të cilin është gjykuar denoncuesi N. K., rezulton se subjekti i rivlerësimit, z. Besnik Cani, nuk lidhet direkt në asnjë rrethanë apo fakt me këtë çështje;
- ii. Subjekti i rivlerësimit, z. Besnik Cani, në atë periudhë ka qenë drejtues i Prokurorisë së Rrethit Shkodër dhe me këtë cilësi ai ka nënshkruar kërkesën për dërgimin në gjykatë të fashikullit hetimor të përgatitur nga prokurori i kësaj çështje;
- iii. Komisioni, si konkluzion, konstatoi se denoncimi i shtetasis N.K. për sa i përket pretendimit “*që ai ishte thirrur në zyrë nga subjekti i rivlerësimit, z. Besnik Cani, ku i janë kërkuar 15.000 euro*” rezultoi i pambështetur në ndonjë provë konkrete, pra ai mbetet vetëm në kuadër deklarimeve të njëanshme të denoncuesit³⁶;
- iv. Sa më lart bazohet edhe në faktin që N.K., është kontaktuar dhe është ftuar që të paraqitej pranë Komisionit për të dhënë shpjegime apo për të paraqitur prova apo elemente të tjera plotësuese/mbështetëse të akuzave të tij, por ai ka refuzuar ta ushtrojë këtë mundësi, duke pohuar që çfarë kishte për të thënë ai e kishte shprehur tashmë.

E/2. Denoncim i paraqitur nga shtetasi A.R.

Në denoncimin e tij, shtetasi A.R. paraqet ankesa ndaj 19 subjekteve të rivlerësimit, ku përfshihet dhe z. Besnik Cani, asokohe me funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier,

³⁶ Arrihet në këtë konkluzion pasi nga ana e Komisionit, është kontaktuar shtetasi N.K. në numrin e telefonit të lënë prej tij (***) më datë 12.10.2018, në mënyrë që ai të paraqitet pranë zyrave të Komisionit më datë 18.10.2018 ora 14:00 për të dhënë deklarime për sa ai ka denoncuar. Më datë 18.10.2018, ora 14:00, Komisioni, konstatoi që shtetasi N. K. nuk ishte prezent ditën që i ishte caktuar për tu paraqitur. Ai u kontaktua përsëri me telefon nga ana e Komisionit, po më datë 18.10.2018, por nga përgjigja e tij, ai refuzoi të vinte të jepte deklarime me arsyen që Komisioni duhet të mjaftohet me ato që janë shkruar në denoncime. Denoncuesi N.K. u telefonua përsëri, më datë 19.10.2018, në numrin e tij dhe iu kërkua nëse mund të vinte përsëri një ditë tjetër që të mund të vinte të jepte shpjegime, por nga ana e tij përsëri u refuzua që të vinte të jepte deklarime. Z. K. iu kërkua që meqë nuk dëshironte të vinte nëse mund të jepte një adresë *e-maili* ku Komisioni ti drejtonte disa pyetje ku ai të përgjigjej po me *e-mail*. z. K. nuk mbante mend adresën e *e-mailit* dhe për momentin nuk ishte në shtëpi dhe kur të shkonte do na e dërgonte me mesazh tek numri që e telefonuam. Në pritje të dërgimit të adresës së *e-mailit* me mesazh, z. K. nuk dërgoi mesazh deri në orën 16:15 dhe pikërisht në këtë orë ai u telefonua përsëri nga telefoni fiks i Komisionit +355 (***) dhe iu kërkua që të na jepte adresën e *e-mailit*. Nga ana e z. K. u refuzua në mënyrë kategorike dhënia e *e-mailit* si dhe mosprezenca e tij në zyrat e Komisionit për deklarime, me justifikimin se nuk kam çfarë të deklaroj tjetër, pasi i kam deklaruar ato që kam tek denoncimet që kam dërguar më parë si dhe ia kam dërguar dhe Prokurorisë së Krimeve të Rënda dhe nuk kam përse jap më deklarime për këtë çështje. Si përfundim nga ana e shtetasis N. K. nuk u tregua gatishmëri për të bashkëpunuar dhe dhënë deklarime për sa ai ka denoncuar nga ana e tij, dhe për Komisionin dhe denoncimet e bëra prej tij mbeten vetëm në fazë “deklarative” të pa provuara.

denoncuesi ka ngritur si problem faktin që subjekti ka miratuar vendimet e prokurorit të çështjes Ç.S. për një proces penal ku A.R. është akuzuar për veprën penale të “vjedhjes” dhe “të pengimit të vendimit të gjykatës”.

Denoncuesi, në këtë denoncim, nuk i referohet ndonjë rrethane konkrete, dhe për rrjedhojë Komisioni vëren se, nga dokumenti në dispozicion, nuk gjendet asnjë indicje apo provë konkrete që të implikojë Subjektin e rivlerësimit, në funksionin e tij si Drejtues i Prokurorisë së Rrethit Fier.

E/3. Denoncim i paraqitur nga shtetasi A.C.

Në këtë denoncim z. A.C. i referohet aferave korruptive të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan në lidhje në hetimet e kryera në çështjet penale të zhvilluara për pronat e tij, të cilat i janë marrë padrejtësisht sipas pretendimeve të tij.

Komisioni pasi kërkoi, të administrojë dhe studiojë dosjet e procedimeve të cituara nga denoncuesi, vëren se nuk u konstatuan parregullsi që mund të lidhen me aktivitetin profesional të subjektit të rivlerësimit, pasi rezultoi se ai, në këtë çështje, vetëm kishte miratuar vendimin e pushimit të procedimit penal të prokurorit të çështjes, i cili nuk paraqiste problematika apo dyshime.

E/4. Denoncim i bërë nga shtetasi S.H.

Ky shtetas, ka denoncuar në lidhje me pasurinë e subjektit dhe ka specifikuar se: “.....Subjekti i rivlerësimit, z. Besnik Cani, posedon një vilë 4-katëshe në P., ku banojnë prindërit e tij dhe një sipërfaqe të madhe toke. Përpara disa vitesh aty ka qenë një barakë 1-katëshe dhe vetëm me paratë e mbledhura nga z. Besnik Cani e kanë bërë një supervilë 4-katëshe.

Subjekti i rivlerësimit, z. Besnik Cani, ka ndërtuar një karburant të shoqërisë “(***)” sh.p.k. Këtë karburant e menaxhon Besniku me njerëzit e tij dhe nxjerr fitime të mëdha. Gjithashtu, z. Besnik Cani, ka dy djem që prej vitesh jetojnë dhe studiojnë në Vjenë, Austri. Nipi im që jeton atje, më ka thënë se ata bëjnë një jetë luksoze, kanë shtëpi me qira në një lagje të shtrenjtë dhe shkojnë në universitetet më të shtrenjta, etj...”

- i. Referuar pjesës së denoncimit të mësipërm, që i referohet çështjes së pikës së karburantit në P., në emër të shoqërisë “(***)” sh.p.k., si dhe jetesës së dy djemve të tij që jetojnë në Vjenë të Austrisë, Komisioni e ka marrë në shqyrtim si pjesë përbërëse të hetimit administrativ të kryer mbi pasuritë dhe mbi shpenzimet familjare, si për të gjithë subjektet e rivlerësimit, edhe ndaj këtij subjekti;
- ii. Në lidhje me pjesën e denoncimit për sa i përket “posedimit të vilës 4-katëshe, nga prindërit e tij në P.” nga ana e Komisionit janë ndërmarrë veprimet hetimore si në vijim:
- iii. Komisioni i është drejtuar me shkresë zyrtare ZVRPP-së Tiranë dhe nga ana e kësaj të fundit me shkresën nr. (***)prot, datë 23.05.2018, ka konfirmuar se në emër të shtetasit B. C. (i ati i z. Besnik Cani) nuk rezulton të ketë të regjistruara pasuri të paluajtshme në ZVRPP-në Tiranë;
- iv. Gjithashtu, Komisioni i është drejtuar ALUIZNI-t me shkresë zyrtare ku i ka kërkuar që të verifikohet nëse në emër të B. C. rezultonte ndonjë praktikë legalizimi pranë këtij institucioni;
- v. ALUIZNI me shkresën nr. (***) prot, datë 05.06.2018, ka dhënë përgjigje pozitive dhe ka dërguar dosjen e praktikës së legalizimit të shtetasit B. C. nga ku rezulton i deklaruar në vitin 2006, në formularin e vetëdeklarimit për legalizim, ndërtesë 2-katëshe me sipërfaqe ndërtimi prej 110 m²;
- vi. Nga fotot që ishin pjesë përbërëse e dosjes në fjalë, rezulton një ndërtesë 2-katëshe, e ndërtuar pa leje ndërtimi, përpara vitit 2006;

- vii. Gjithashtu për të verifikuar këtë fakt, si dhe për të identifikuar këtë banesë, lidhur me mundësinë e ndonjë shtese në katet e mësipërme të saj, në vitet e mëpasshme, Komisioni, ka kryer edhe këqyrje në terren, dhe nga verifikimet e bëra ka rezultuar vetëm prezenca e po të njëjtës ndërtesë 2-katëshe, në P. të Tiranës, të ndërtuar më herët, për të cilën ishte kërkuar legalizimi;
- viii. Meqenëse duke iu referuar denoncimit të shtetasit S.H. që deklaroi vilë 4-katëshe në P. dhe provave dhe fakteve që kishim të bënim me një ndërtesë 2-katëshe, dhe duke qenë se ishte konstatuar kjo mospërputhje, Komisioni vendosi që të komunikojë me denoncuesin/shtetasin S.H., për ta thirrur atë pranë këtij institucioni, për të marrë informacione të tjera për sa ai kishte denoncuar, dhe për ti kërkuar sqarime se pse faktet rezultojnë që të ishin ndryshe;
- ix. Pasi u tentua të kontaktohej denoncuesi S. H. në numrin e telefonit të referuar në denoncimin e nënshkruar prej tij, rezultoi se ai numër telefoni nuk ishte i plotë, pasi kishte një shifër mangët;
- x. Në vijim, Komisioni, dërgoi shkresë pranë shoqërisë (***) sh.a. meqenëse numri i shënuar kishte prefiksën “069” që i përkiste kësaj shoqërie, por nga ana e kësaj shoqërie me shkresën nr. (***) prot, datë 11.06.2018, na u komunikua se shtetasit me emër S.H. nuk i përkiste asnjë numër i dhënë nga ajo shoqëri;
- xi. Gjithashtu, Komisioni, dërgoi një shkresë zyrtare denoncuesit S.H., në adresën e lënë nga vetë denoncuesi, ku i kërkohej të paraqitej pranë këtij institucioni, për të dhënë disa shpjegime në lidhje me denoncimin e paraqitur, por nga ana e shërbimit postar na u komunikua që në atë adresë nuk ekzistonte asnjë shtetas me emër S.H.;
- xii. Referuar sa më sipër, pas veprimeve hetimore jo plotësisht produktive, Komisioni vlerëson se nuk u arritën të provoheshin tërësisht pretendimet e ngritura nga denoncuesi S.H. ndaj subjektit të rivlerësimit, z. Besnik Cani, si dhe nuk u konstatuan problematika profesionale – përtej hetimit dhe vlerësimit të kryer veçmas mbi marrëdhënien kontraktore me kompaninë “(***)” sh.p.k.;

E/5. Denoncim i paraqitur nga shtetasi B.V.

Në denoncimin në fjalë ky shtetas ka denoncuar z. Besnik Cani në lidhje me periudhën “... kur subjekti ka qenë prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Tiranë, - sipas tij - ka mbyllur çështjen e shtetasit V.H., i akuzuar për vrasjen e R.V.T. Çështja penale, nr. (***), e vitit 2007. Gjithmonë, sipas denoncuesit, - shtetasi V.H. ka paguar shumën 50.000 euro për mbylljen e kësaj çështje nga z. Besnik Cani...”

- i. Referuar këtij procedimi penal, për hetime të mëtejshme: Komisioni ka administruar dosjen e procedimit penal, nr. (***), të vitit 2007, dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit në dosje ka rezultuar se:
- ii. Nga ana e subjektit të rivlerësimit, z. Besnik Cani, në hetimin e kësaj çështje ka pasur mangësi profesionale lidhur me mos thellimin e hetimeve; me mungesë arsyetimi dhe marrje e një vendimi pushimi “sipërfaqësor” dhe më vonë, pas kryerjes së hetimeve të mëtejshme nga vetë subjekti – por në sajë të urdhrimit të drejtuesit të tij – ai arrin në një konkluzion të kundërt, duke kërkuar gjykimin për V. H., me akuzën e “shkaktimit të vetëvrasjes” - për të njëjtat fakte mbi të cilat më parë ai i kishte pushuar hetimet;³⁷

³⁷Ky vlerësim është jo i plotë. Sipas vendimit të eprorit rezultojnë se subjekti i rivlerësimit, z. Besnik Cani, nuk ka kryer hetime të thelluara dhe gjithë përfshirëse. Gjë që ai e bëri më vonë dhe për rrjedhojë të këtyre hetimeve shtesë, z. Cani ndryshon qëndrim/vendim dhe integron akuzën e “shkaktimit të vetëvrasjes” – për të cilën më parë kishte kërkuar pushimin e hetimeve. Më pas kjo akuzë konfirmohet e provohet edhe në gjykatë, e cila e dënon të pandehurin edhe

- iii. Gjithsesi, Komisioni nuk e konsideron këtë mangësi të rëndë pasi, nuk ka pasur pasoja, falë hetimeve të mëtejshme dhe konkludimit të ndryshëm dhe të korrigjuar në rrugë e sipër.

E/6. Kallëzim ndaj vendimit për pushimin e procedimit penal nr. (*)2013**

Shtetasi E.K. kishte bërë kallëzim ndaj disa shtetasve, ndaj prokurores F.L. “Për pushimin e procedimit penal, nr. (***)”, të vitit 2013, si prokurore e çështjes, ndërsa ndaj subjektit ai ka ngritur pretendimin se drejtuesi Besnik Cani ka miratuar vendimin e pushimit në fjalë, të pabazuar.

Në lidhje me këtë çështje Komisioni, - pasi kërkoi, administrojë dhe studiojë dosjet që i përkisnin procedimet penal në fjalë, - vlerëson se subjekti mund të kishte urdhëruar prokuroren e çështjes të kryente hetime më të thelluara, - duke prishur vendimin e pushimit. Gjithsesi, nuk është evidentuar ndonjë implikim direkt i subjektit në veprimet apo mosveprimet hetimore dhe nuk konstatohet ndonjë pasojë apo përgjegjësi (direkte) e drejtuesit në lidhje me konkluzionin në të cilin ka mbërritur prokuroria e çështjes në këto hetime.

E/7. Mbi vendimin “Për mosfillim” në vijim të kallëzimit penal nr. (*)/2012 dhe procedim penal nr. (***)/2012, pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier.**

Në vijim të konstatimit të një artikulli, të botuar në media, më datë 10.09.20108, *mbi prezumimin e përfitimeve të padrejta nga ana subjektit të rivlerësimit, si dhe mbi një aludim/akuzim se z. B. Cani, - asokohe drejtues i Prokurorisë së Rrethit Fier, - kishte qenë “i butë” dhe kishte mbajtur jashtë burgut kryebashkiakun e Fierit si dhe disa të hetuar të tjerë³⁸, dhe njëkohësisht kishte përfutuar statusin e familjes së pa strehë duke pasur pronësi³⁹, u kryen veprimet hetimore si në vijim;*

- i. Komisioni kërkoi dhe administroi, më datë 03.10.2018, nga Prokuroria Pranë Gjykatës së Rrethit Fier, dosjen hetimore në ngarkim të shtetasve B. Z. (kryebashkiaku i Fierit) dhe të anëtarëve të Komisionit të Strehimit pranë Bashkisë Fier;
Nga materialet e kësaj dosje hetimore ka rezultuar se:
- ii. Më datë 16.07.2012, nga ana e Prokurorisë Fier mbi bazën e kallëzimit të 15 ankuesve është regjistruar kallëzimi penal nr. (***)
- iii. Me vendimin e datës 30.07.2012, prokuroria ka vendosur “Për mosfillimin e procedimit penal” të kallëzimit penal nr. (***) të vitit 2012. Ky vendim është marrë nga prokurorja e çështjes A. Z. e cila ka arsyetuar se: “fakti përveç që nuk parashikohet nga ligji si vepër penale është rrjedhojë e një votimi të fshehtë kolegjal dhe objekt i një procedure ankimi administrativ e cila edhe është ndjekur në rastin konkret”;
- iv. Në këtë dosje gjejmë të depozituar një shkresë të datës 04 shtator 2012 me lëndë: *Dërgim njoftim vendimi mosfillimi, e nënshkruar nga drejtuesi z. Besnik Cani.*⁴⁰
- v. Më pas, kallëzuesit ankimojnë vendimin, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, ku kërkojnë prishjen e vendimit të mosfillimit në fjalë;

për këtë akuzë... (edhe pse më tej Gjykata e Apelit e deklaroi të pafajshëm mbi këtë pikë). Pra rezultoi një kryerje hetimesh më mangësi dhe vërehen ndryshime qëndrimi mbi të njëjtën dosje hetimore prej subjektit të rivlerësimit, z. Besnik Cani;

³⁸ Anëtarë të Këshillit Bashkiak Fier;

³⁹ Pra duke mos i plotësuar kriteret ligjore për marrjen e statusit të pastrehë;

⁴⁰ Kjo do të thotë se drejtuesi e ka miratuar këtë vendim, edhe pse jo në mënyrë eksplicite (gjë që ndoshta është detyrë e tij që të shprehej, për miratim apo për ç’fuqizim të vendimit të prokurores së çështjes).

- vi. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin e datës 06 shkurt 2013, disponon, *Pranimin e kërkesës për prishjen e vendimit të mosfillimit dhe urdhëron prokurorinë të kryejë veprime hetimore*;
- vii. Më datë 31.10.2012, Prokuroria e Rrethit Fier ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal nr. (***) për veprën penale të, *“Shpërdorimit të detyrës”*, në bashkëpunim si dhe veprën penale të, *“Falsifikimit të dokumenteve”*;
- viii. Më datë 26.03.2013, nga ana subjektit, në cilësinë e Drejtuesit të Prokurorisë Fier, është marrë vendimi për *“Bashkimin e procedimeve”* ku vendos bashkimin e procedimit penal nr. (***), datë 20.03.2013, dhe të procedimit nr. (***)/2012 meqenëse të dy procedimet bëjnë fjalë për të njëjtin fakt penal të pretenduar, shpërdorim i detyrës nga anëtarët e Këshillit Bashkiak, dhe ngarkon prokurorin A.C. për kryerjen e veprimeve hetimore të urdhëruara nga Gjykata;
- ix. Ndërkohë, gjatë kësaj periudhe, kallëzuesit/shtetasit A.I. dhe 14 të tjerë i janë drejtuar edhe Gjykatës Civile së Rrethit Gjyqësor Fier, me një kërkesë padi me objekt ndryshimin e vendimit të Këshillit Bashkiak, nr. 31, datë 09.07.2012, - me palë të paditur Këshillin Bashkiak Fier;
- x. Pas shqyrtimit të çështjes, Gjykata Rrethit Fier me vendimin nr. 982, më datë 11.03.2013, kishte vendosur: Pranimin e padisë; Konstatimin e pavlefshmërisë së aktit administrativ: Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 31, dhe detyrimin e Këshillit Bashkiak Fier për të rinxjerrë aktin administrativ për ndarjen e banesave sociale;
- xi. Më datë 26.12.2014⁴¹, nga ana e prokurorit të çështjes A.C. merret vendimi: *“Për dërgimin në gjyq, të çështjes penale nr. (***), viti 2012, në ngarkim të B.Z. etj...;*
- xii. Referuar dokumentacionit në dosjen penale dhe të gjithë situatës së relatuar më sipër, rezulton se subjekti ka qenë drejtues i organit të Prokurorisë së Rrethit Fier, në fazën e parë të hetimeve në lidhje me çështjen në fjalë, dhe deri në momentin që, z. Besnik Cani, ka mbuluar këtë detyrë, rezulton që në lidhje me këtë çështje kishte pasur vetëm një vendim mosfillimi – të miratuar nga vetë subjekti – dhe më vonë të ç’fuqizuar nga gjykata, që kishte urdhëruar kryerjen e hetimeve të tjera, në vijim të të cilave prokurori i ri dhe drejtuesi i ri i caktuar në vend të subjektit, kërkuan dërgimin e çështjes në gjyq⁴²;
- xiii. Komisioni, në analizë të materialeve të mësipërme, përtej pasivitetit dhe mungesës së efikasitetit hetimor, nuk konstaton prova të një ndikimi të drejtpërdrejtë të subjektit në këtë çështje, - siç ishte aluduar - me qëllim favorizimin e kryebashkiakut apo të ndonjë personi nën hetime për këtë procedim penal. Për rrjedhojë, mangësia profesionale e mundshme e subjektit në rastin konkret konsiston vetëm në lidhje me vlerësimin e gabuar që ai ka kryer në momentin e miratimit - në cilësinë e drejtuesit - të vendimit të mosfillimit në fjalë, të marrë nga prokurorja titullare e çështjes, dhe më pas të prishur nga gjykata;
- xiv. Në vijim të sa më lart, Komisioni vlerëson se, mospasja e provave mbi një ndikim të paligjshëm nga ana e subjektit në lidhje me vendimin e mosfillimit të sipërcituar, apo edhe në lidhje me VKB Fier, nr. 14/2013, mbi dhënien e statusit të pastrehë për familjen e tij, nuk përjashton prezencën e dyshimeve mbi një përgjegjësi të tij, së paku nën këndvështrimin e cenimit të etikës profesionale dhe të zbehjes apo humbjes së besimit të publikut tek figura e magistratit;

⁴¹ Pas rreth dy vite e gjysmë nga paraqitja e 15 kallëzimeve nga palët e dëmtuara;

⁴² Ndërkohë, Bashkia Fier kishte në shqyrtim procedurat e vlerësimit të kritereve për familjet e pastrehe, ndër të cilave u shpall fituese e statusit edhe familja e z. B. Cani (në Mars 2013). Për këtë shkak mund të ketë pasur një konflikt interesi (të paktën në dukje);

- xv. Në sajë të arsytetimeve të mësipërme, Komisioni çmon se fakti i miratimit nga, z. Besnik Cani, të vendimit të mosfillimit, në vetvete dhe në mungesë të provave ndërlidhëse mbi një ndikim të paligjshëm nga ana subjektit, mbi prokuroren konceptuese të këtij vendimi dhe/ose mbi Këshillin Bashkiak Fier, në lidhje me VKB, nr. 14/2013, apo mbi një përfitimin⁴³ të paligjshëm nga funksioni i tij, si drejtues i prokurorisë në atë rreth, nuk mund të çojë në aplikimin e pikës 1, germa“c” të nenit 58 të ligjit nr. 84/2016, si dhe konsiderohet i pamjaftueshëm për të aplikuar masën e parashikuar në pikën 5 të nenit 61 të po këtij ligji. Për rrjedhojë trupi gjykues çmon se edhe kjo rrethanë, në zbatim të pikës 4, nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, duhet të përcillet pranë organit kompetent për inspektimin e shkeljes disiplinore, për një vlerësim të përgjithshëm - së bashku me VKB Fier nr. 14/2013 dhe me problematikat e tjera profesionale të konstatuara - për caktimin e një mase, në harmoni me parimin e proporcionalitetit;

E/8. Denoncimi ndaj vendimit të mosfillimit në lidhje me procedimin penal nr. (*)të vitit 2006, - i paraqitur nga shtetasi V.Ç.**

Në denoncimin e tij, z. V.Ç. ankohet ndaj një vendimi mosfillimi të marrë pas kallëzimit të bërë prej tij, ndaj shtetasve F. dhe T. Ll. për veprën penale të “Falsifikimit” në bashkëpunim, në procedimin penal nr. (***) të vitit 2006. Ankimit i janë bashkëlidhur dokumente dhe CD, si prova plotësuese;

- i. Nga studimi dhe verifikimi i dokumentacionit shoqëruar dhe nga përmbajtja e CD-ve të bashkëngjitura, nuk u konstatuan prova apo indice përgjegjësie, lidhur me veprimtarinë profesionale të Subjektit të rivlerësimit;
- ii. Komisioni, ka kërkuar dhe administruar dosjen hetimore të procedimit penal nr. (***) të vitit 2009 që lidhej/përmbante edhe me procedimin e mësipërm dhe me kallëzimin penal (***)/2007, dhe nga studimi dhe analizimi i saj rezultoi se:
- iii. Më atë 22.11.2007 nga ana e z. Sh.K. - me cilësinë e zv/prokurorit të rrethit - dhe nga z. Besnik Cani, si prokurori i çështjes, ishte marrë vendimi “*Për mos fillimin të procedimit penal/të kallëzimit penal nr. (***)*” të bërë nga shtetasi V. Ç. ndaj shtetasve F. dhe T. Ll. për veprën penale të “*Falsifikimit të dokumenteve*” me arsyetimin se **nuk konstatohen elementë të ndonjë vepre penale.**
- iv. Sa më lartë, arsyetohej me faktin se Gjykata Civile e Shkallës së Parë, ka shqyrtuar të gjitha provat e pretendimet e palëve dhe e ka zgjidhur çështjen. Gjatë këtij gjykimi kjo gjykatë (civile) nuk ka konstatuar ndonjë akt të falsifikuar, që në bazë të nenit 271, 272 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, që e detyron Gjykatën të pezullojë shqyrtimin gjyqsor dhe të bëjë kallëzim për ndjekje penale;
- v. Më pas, shtetasi V. Ç. e ka ankimuar këtë vendim mosfillimi, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila me vendimin e saj të datës 07.10.2008, ka vendosur: “**Pranimin e kërkesës së kërkuarit V.Ç. me nr. (***) akti, datë 05.12.2007 sipas objektit “Kundër vendimit të mosfillimit të procedimit penal nr(***), datë 22.11.2007 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë”;**
- vi. Gjykata në arsyetimin e saj, ka përmendur faktin se **organi i prokurorisë nuk ka pasur parasysh provat dhe faktet që janë paraqitur nga kallëzuesi si dhe dy vendime me të njëjtin numër**

⁴³ Kujtojmë që kredia e butë nuk është përfituar nga familja e subjektit, pasi procedura është ndërprerë (sipas Subjektit me iniciativën e tij dhe të bashkëshortes);

- dhe datë, por me përmbajtje (lidhur vetëm me shifrat e sipërfaqes së tokës) të ndryshme. Ky vendim nuk rezultoi të jetë ankimuar nga ana e prokurorisë;**
- vii. Pas këtij vendimi të Gjykatës të sipërcituar, Prokuroria e Tiranës vendosi regjistrimin e procedimit penal me kallëzues V.Ç. dhe çështja vijoi që të hetohej/ndiqej nga prokurori Besnik Cani, i cili - pasi kryen veprime të tjera hetimore, merr në pyetje dëshmitarë, urdhëron akt-ekspertimi etj, - **vendos të dërgojë çështjen në gjyq, me akuza në ngarkim të të pandehurve F. dhe T. Ll., për veprën penale të “Falsifikimit të dokumenteve, në bashkëpunim”;**
- viii. **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në përfundim të gjykimit të kësaj çështje, me vendimin nr. 510, datë 01.04.2011 ka vendosur: “Deklarimin fajtor të të pandehurit F. dhe T. Ll. për kryerjen e veprës penale ‘Falsifikimi i dokumenteve në bashkëpunim në formën e përdorimit’ dhe dënimin e secilit prej tyre me nga 6 muaj burgim dhe 300,000 lekë gjobë”;**
- ix. Pas ankimit të bërë ndaj këtij vendimi nga të pandehurit, **Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 983, datë 09.09.2011, ka vendosur: “Prishjen e vendimit nr. 510, datë 01.04.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe pushimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurve F. dhe T. Ll., me arsyetimin se ekzistojnë shkaqe padënueshmërie, për shkak të parashkrimit” – por nuk i ka shpallur të pafajshëm të dënuarit në shkallë të parë...;**
Për sa më lart, Komisioni vëren se:
- i. Duke iu referuar vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë që ka vendosur pranimin e ankimit të kallëzuesit V. Ç. për rifillimin e hetimeve, **Subjekti, B. Cani, nuk duhet të kishte vendosur mosfillimin por duhet të kishte urdhëruar kryerjen e hetimeve të thelluara dhe të gjithanshme mbi këtë çështje⁴⁴ dhe të mos ishte mjaftuar vetëm me referim të vlerësimeve dhe veprime e kryera, apo mosveprimet nga Gjykatat gjatë procesit civil - të cilat, sipas Subjektit “nuk kishin konstatuar ndonjë falsifikim, nuk kishin pezulluar çështjen civile dhe nuk e kishin përcjellë dosjen në Prokurori”;**
- ii. Duhet të ishin kryer hetime gjithëpërfshirëse dhe të thella, mbi dy dokumentet në dosje, ku njëri ishte kallëzuar si i falsifikuar, përpara sesa të arrihej në një konkluzion. Subjekti duhej të kishte kryer prej fillimit, ato veprime hetimore që u kryen prej tij më pas, dhe që në sajë të të cilave, vetë z. B. Cani, arriti në përfundimin që të dërgonte çështjen në gjyq, - pra Subjekti pas hetimeve arriti në një vendim/përfundim të kundërt me atë që, ai vetë, kishte marrë në fillim, duke mos i konsideruar të nevojshme hetimet, për aq kohë sa ai vendosi mosfillimin e tyre;
- iii. Komisioni, - në lidhje me menaxhimin dhe me qasjen e Subjektit në fazën fillestare të procedimit që po analizojmë - ka konstatuar mangësi hetimesh, mungesë arsyetimi (bindës) në vendimin e mosfillimit dhe konkluzion të pabazuar dhe/ose të gabuar, pasi në vijim të prishjes së vendimit të mosfillimit, dhe të urdhrat të Gjykatës – u kryen hetimet, rezultatet e të cilave çuan në konkluzione krejt të kundërta, - me dërgim në gjykim (të vendosur po nga vetë Subjekti), dhe më pas në deklarinin fajtor dhe dënimin e dy të denoncuarve (F. dhe T. Ll.);
- iv. Gjithashtu, konsiderohet i rëndësishëm dhe domethënës fakti që dokumenti i falsifikuar⁴⁵ ishte qysh në fillim pjesë e dosjes së bashku me dokumentin origjinal – ku të dhënat midis tyre ishin të gjitha njëjloj, me përjashtim të shifrës së sipërfaqes së tokës së kthyer në pronësi, pasi tek

⁴⁴ Veprimet hetimore që janë urdhëruar nga gjykata, që prishi vendimin e mosfillimit, dhe që më pas janë drejtuar dhe kryer nga vetë z. B. Cani;

⁴⁵ Siç rezultoi edhe nga hetimet e kryera nga vetë z. B. Cani, pas urdhrat që i bëri të detyrueshme ato;

- dokumenti i falsifikuar ajo rezultonte e shtuar/falsifikuar me 10.000 m² më shumë, nga sa ishte vendosur nga Organi kompetent⁴⁶;
- v. Pra mospërputhja/ndryshimi midis dy dokumenteve – që veç të tjerash, ishte edhe objekti i kallëzimit – rezultonte lehtësisht e verifikueshme, dhe do të mjaftonte vetëm caktimi i një eksperti për të konstatuar edhe formalisht këtë fakt⁴⁷ (siç ndodhi më vonë). Pra nuk kishte arsye dhe shkaqe mosfillimi, siç kishte vendosur Subjekti;
- vi. Subjekti, - pasi u njoh me gjetjet, konstatimet dhe dyshimet e shprehura nga Komisioni, mbi këtë çështje, - ka paraqitur shpjegime dhe dokumente mbështetëse, nëpërmjet të cilave është provuar fakti se asokohe, në Prokurorinë e Rrethit Tiranë, kishte një praktikë pune, në bazë të të cilës, Drejtuesi dhe zv/Drejtuesi, mund të bashkë konceptonin dhe të bashkë firmosnin – pra të ishin bashkautorë – vendimet e mosfillimit, pushimit apo të dërgimit në Gjykatë;
- vii. Ndërsa në lidhje me vendimmarrjen e mosfillimit të hetimeve, Subjekti shpjegoi se *asokohe ishte vënë re një shumëfishim i kallëzimeve për çështje pronësie, dhe për këtë arsye ishte marrë një vendim mbi politikën strategjike të menaxhimit të çështjeve – për të s'mbrapsur këtë dyndje kallëzimesh – dhe në vijim ata (prokurorët) kishin urdhëresë të mos humbnin shumë kohë pas këtyre dosjeve - që lidheshin me pronësitë e tokave;*
- viii. Gjithsesi, Komisioni, në një vlerësim të përgjithshëm të veprimtarisë hetimore në lidhje me dosjen e analizuar të këtij procedimi, arrin në konkluzionin se Subjekti ka munguar në analizimin e përmbajtjes së dosjes në fjalë; fillimisht ka marrë një vendim mosfillimi të pabazuar; të argumentuar në mënyrë jo bindëse; nuk ka marrë parasysh provat që gjendeshin brenda në dosje; në një moment të dytë, e ka rikuperuar situatën, - por vetëm në sajë (dhe pasi) Gjykata kishte urdhëruar kryerjen e hetimeve, pasi kishte ç'fuqizuar vendimin e mosfillimit;
- ix. Në konkluzion, pasi Komisioni ka konstatuar mangësi në veprimtarinë hetimore të Subjektit, por gjithsesi duke vlerësuar se z. Besnik Cani e arrin, së paku, nivelin minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale - duke pasur parasysh sa më lartë si dhe shkaqet e sipërpërmendura, në pikat e mësipërme, lidhur me problematikat e tjera të konstatuara në dosjet profesionale të denoncuar nga publiku, - Trupi Gjykues çmon se edhe dosjet që lidhen me këtë procedim penal, (nr. (***)/2006 - kallëzimin penal (***)/2007 - procedimit penal nr. 40 të vitit 2009, në zbatim të pikës 4, nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, duhet të përcillen pranë organit kompetent për inspektimin e shkeljeve të mundshme disiplinore.

Duke konkluduar në mënyrë përmbledhëse mbi të tre kriteret e rivlerësimit, trupi gjykues, ka konstatuar se:

a- në lidhje me rivlerësimin e pasurisë, subjekt i rivlerësimit:

- i. Ka kryer pasaktësi në deklaratimet periodike, por pa pasur si qëllim apo si pasojë fshehje të pasurisë, apo mosdeklarimin e burimit financiar të përdorur për blerjen e ndonjë pasuri;
- ii. Kanë rezultuar disa **mangësi të burimeve financiare**, - për një total të akumuluar **në pesë vite** (dhe të shpërndara në harkun kohor 11 vjeçar), **në shumën prej 819,812 lekësh**, të cilat konsiderohen jo **të mjaftueshme që të pasjellin aplikimin e pikës 3 të nenit 61 të**

⁴⁶ Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave;

⁴⁷ Fakt i cili ishte lehtësisht i verifikueshëm, edhe pa qenë ekspert, dhe që duhej të ishte konstatuar dhe evidentuar edhe nga vetë Prokurori dhe nga OPGJ-të;

ligjit nr. 84/2016;

- iii. Nuk është konstatuar fshehje pasurie.

b- në lidhje me kontrollin e figurës:

- iv. Rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklaramentit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi;
- v. Nga analiza e të dhënave të parashikuara në pikën 1, neni 38, i ligjit nr. 84/2016, dhe kryesisht bazuar në raportin e DSIK-së, rezultoi që subjekti i rivlerësimit nuk ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar;
- vi. Nga rivlerësimi i kryer nga Komisioni, nuk u konstatua asnjë element që mund të çonte në prova apo në dyshime të arsyeshme mbi ekzistencën e mundëshme të kontakteve të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo mbi mangësi në integritetin e subjektit në fjalë dhe për rrjedhojë konkludohet se, z. Besnik Cani, është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

c- në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale:

Rezultoi se, pavarësisht vlerësimit pozitiv të Grupit të Punës së Prokurorisë së Përgjithshme, Komisioni ka konstatuar disa problematika lidhur me aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, si dhe disa dyshime të arsyeshme në lidhje me etikën – të cilat gjithsesi nuk janë të mjaftueshme për të konkluduar se z. Besnik Cani nuk arrin një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive të tij profesionale, dhe për këtë arsye trupi gjykues çmon që, në zbatim të pikës 4, nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, të përcjellë të gjitha praktikant/dosjet/aktet me dyshime apo problematika, pranë organit kompetent për inspektimin e shkeljeve të mundshme disiplinore. Për rrjedhojë,

Për sa më lart, trupi gjykues arrin në përfundimin se sipas parashikimit të nenit 59/1, germa “a”, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit, z. Besnik Cani:

- i. ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;**
- ii. ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;**
- iii. ka arritur së paku një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.**

Në këto kushte Komisioni, bazuar në provat që disponon, vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe bindjen e brendshme, arrin në konkluzionin që subjekti i rivlerësimit, z. Besnik Cani, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, të konfirmohet në detyrë.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës, në nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika

1, germa “a” dhe nenit 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjekti i rivlerësimit, z. Besnik Cani, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.
2. Në zbatim të pikës 4 nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, të përcjellë disa çështje/praktika pranë organit kompetent për inspektimin e shkeljeve të mundshme disiplinore, si më poshtë vijon:
 - a. Praktika e marrëdhënies juridiko-civile ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me shoqërinë “(***)” sh.p.k.;
 - b. Çështja me nr. 1380, të vitit 2006, pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë;
 - c. Dosja e procedimit penal me nr. 1079, të vitit 2012, pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, së bashku me praktikën për përfitimin e statusit të pa strehë, në bazë të Vendimit të Këshillit Bashkiak Fier, nr. 14, datë 28.03.2013;
 - d. Çështja me nr. (***), të vitit 2015, pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan.
3. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
4. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
5. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, më datë 27.11.2018.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Olsi Komici
Kryesues

Lulzim Hamitaj
Relator

Brunilda Bekteshi
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Denisa Kosta